

1 E mërkurë, 13 korrik 2022
2 [Konferencë për Ecurinë e Gjendjes]
3 [Seancë e hapur]
4 [Të akuzuarit marrin pjesë përmes videolidhjes]
5 --- Fillon në orën 13.31

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve dhe
7 mirë se keni ardhur brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Znj. Sekretare, ju lutem, a mund të thërrisni çështjen.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita i nderuar
10 Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim THAÇIT, Kadri VESELIT, Rexhep
12 SELIMIT dhe Jakup KRASNIQIT.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Shumë faleminderit, znj.
14 Sekretare.

15 Tani ju kërkoj përzemërsish palëve të prezanton, duke
16 filluar si zakonisht me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

17 Znj. Prokurore fjala për ju.

18 ZNJ. LAWSON [Përkthim] I nderuar Gjykatës, mirëdita. Për
19 Zyrën e Prokurorit të Specializuar të pranishëm sot janë Alan
20 Tieger; Ward Ferdinandusse; Marlene Yahya Haage; Matthew
21 Halling dhe unë jam Clare Lawson, Prokurore.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
23 Prokurore.

24 Tani më lejoni t'i jap fjalën Mbrojtjeve, duke filluar me
25 z. Kehoe.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Mirëdita, unë jam Gregory Kehoe.
2 Kemi këtu së bashku edhe Sophie Menegon dhe Bonnie Johnsto,n
3 në emër të Hashim Thaçit.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 Z. Emerson.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës. Unë
7 përfaqësoj z. Veseli së bashku me z. Andrew Strong, znj. Annie
8 O'Reilly, z. Hajredin Kuçi, znj. Pascale Langlais dhe znj.
9 Cosima.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

11 Ju lutem, Mbrojtja për z. Rexhep Selimi.

12 Z. YOUNG: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës. Unë
13 jam Robert Young dhe së bashku me ne sot është Gregory Roberts
14 dhe Rudina Jasini, Sara Jusufi, gjithashtu.

15 Ju kërkoj ndjesë, znj. Jasini po na ndjek përmes
16 videolidhjes.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po, e shikojmë në ekran.

18 Znj. Alagendra.

19 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Përshëndetje, jam përfaqësuese
20 e z. Jakup Krasniqi. Të pranishëm në sallën e gjyqit janë
21 Aidan Ellis, znj. Laura Abia, znj. Jessica Zhou dhe në
22 videolidhje së bashku me mua është z. Mentor Beqiri.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Shumë faleminderit. Për
24 procesverbal vërej se z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z.
25 Krasniqi nuk janë të pranishëm fizikisht në sallën e gjyqit

1 por e ndjekin këtë seancë përmes videolidhjes.

2 Tani i drejtohem Mbrojtëses së Viktimave, znj.

3 Radziejowska. Ju kërkoj ndjesë, në qoftë se jua shqiptova keq
4 emrin.

5 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] E thatë shumë mirë. Unë jam
6 znj. Radziejowska dhe jam përfaqësuese e viktimave në këtë
7 çështje.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani i drejtohem Zyrës
9 Administrative.

10 ZNJ. DONLON: [Përkthim] Përshëndetje, i nderuar Gjykatës.
11 Unë jam Fidelma Donlon, jam Administratore dhe jam së bashku
12 këtu me një staf tjetër të Zyrës Administrative.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Për procesverbal unë jam
14 Nicola Guillou, Gjykatës i procedurës paraprake të çështjes.

15 Më 1 korrik 2022, unë planifikova Konferencën e 13-të për
16 Ecurinë e Çështjes. Ju kërkoja palëve që të bënin parashtrimet
17 e tyre me shkrim në qoftë se dëshironin.

18 Më 8 korrik 2022, ZPS-ja dhe katër ekipet e Mbrojtjeve
19 dorëzuan parashtrimet e tyre me shkrim.

20 Qëllimi i ditës së sotme është që të rishikojmë ecurinë e
21 çështjes dhe të diskutojmë për temat në rendin e ditës;
22 veçanërisht nxjerrjet e materiale hetimet e Mbrojtjes dhe
23 hapat pasues si dhe propozimet për racionalizimin e çështjes.
24 I ftoj palët të përfaqësojnë, të japin pikëpamjet e tyre në
25 mënyrë të përmbledhjet për secilin prej këtyre zërave.

1 Përpara sesa të kalojmë në temën e parë të rendit të
2 ditës për sot, dëshiroj që të diskutojmë bashkërisht një
3 çështje paraprake që ka të bëjë me tabelën sipas rregullës
4 109(c) që është parashtrim i protokolluar F663.

5 Vërej se tabela sipas rregullës 109(c) është dorëzuar me
6 28 janar 2022. Por që prej asaj kohe unë kam nxjerrë disa
7 vendime, - për shembull, vendimin F727, F779 dhe FF876 - që
8 autorizojnë materiale të mëtejshme sipas rregullit 102(1)(b)
9 që të shtohet në listën e provave materiale. Për rrjedhojë, e
10 vlerësoj të domosdoshme që të bëhet një plotësim për tabelën
11 sipas rregullit 109(c), pasi të gjitha kërkesat për ndryshimet
12 për listën e provave materiale të jenë trajtuar.

13 Dua të di në qoftë se ZPS-ja është në pozitë që të japë
14 një plotësim të tillë deri më 30 shtator 2022.

15 Znj. Prokurore, fjala për ju.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, mund ta
17 bëjmë këtë gjë.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

19 Prokurore.

20 Tani do të jap urdhrin e parë me gojë, me përjashtim të
21 rasteve kur Mbrojtja dëshiron të marrë fjalën, por nuk më
22 duket sikur ndonjë nga ekipet e Mbrojtjes do të marrë fjalën.

23 Do të jap urdhrin e parë gojor.

24 Unë urdhëroj që ZPS-ja të japë plotësimin për tabelën
25 sipas rregullit 109(c) deri me 30 shtator 2022. Ky plotësim

1 duhet të përfshijë materialin që i duhet shtuar listës së
2 provave materiale dhe duhet të përfshijë të gjitha materialet
3 sipas rregullës 102(1)(b), mbi listën e provave materiale që
4 aktualisht nuk përfshihen në tabelën sipas rregullës 109(c).

5 Ky është fundi i urdhrit tim të parë gojor.

6 Le të kalojmë tani tek tema e parë e rendit të ditës, që
7 është nxjerrja e materialeve. Do t'i jap fjalën palëve për
8 nxjerrjen e secilës prej kategorive të mbetura të materialit
9 provues, veçmas.

10 Së pari, për materialin sipas rregullës 103 që nuk është
11 në rendin e ditës, megjithatë dua që të dëgjoj palët lidhur me
12 kërkesën nga Mbrojtja e Krasniqit në parashtrimet me shkrim
13 për këtë konferencë për ecurinë e çështjesh.

14 Së dyti, për materialin sipas rregullës 102(3) që është
15 një çështje që ka lidhur me çështjen -- është një material që
16 ka lidhje me çështje siç është renditur nga ZPS-ja.

17 Dhe së treti, me materialin 107, që është material i
18 mbrojtur, për të cilën kërkohet pëlqimi i dhënësit të
19 informacionit.

20 Le të fillojmë me materialin sipas rregullës 103, në
21 veçanti, me kërkesën e Mbrojtjes së Krasniqit për të
22 përcaktuar një afat për kontrollime të synuara për material
23 shfajësues.

24 Në konferencën e fundit për ecurinë e çështjes urdhërova
25 ZPS-në që të përfundonte rishikimin e materialit të vet të

1 marrë pas janarit 2022 dhe të dorëzonte kërkesa për masa
2 mbrojtëse ose të nxirrte materialin që bie -- që është në
3 fushën e veprimit të rregullit 103.

4 Më 30 qershor 2022, ZPS-ja tregoi se e kishte përfunduar
5 rishikimin e materialeve të regjistruara në periudhën nga 21
6 janari 2022 dhe 16 qershori 2022 dhe se ajo kishte nxjerrë ato
7 materiale që përfshihen në informacione sipas rregullit 103,
8 me përjashtimin e nëntë dokumenteve që kishin të bënin me një
9 kërkesë që ishte ende pezull lidhur me masat mbrojtëse.

10 Mbaj shënim që nxjerrja e materialit shfajësuar është
11 përfunduar nga ZPS-ja, me përjashtimin e materialeve që kanë
12 të bëjnë me kërkesat për masa mbrojtës, për të cilat ende nuk
13 është marrë një vendim.

14 Megjithatë, i kujtoj ZPS-së se material i ri provues i
15 marrë nga ZPS-ja duhet që të analizohet, pasi nxjerrja e
16 materialit shfajësues është një detyrim në vijimësi.

17 Vërej gjithashtu që në parashtrimet e veta me shkrim
18 Mbrojtja e Krasniqi unë të përcaktoj një afat për ZPS-në që të
19 përfundojë kontrollime të tjera të synuara për material
20 shfajësuese. Mbrojtja e Krasniqit rikujton se ZPS-ja ka
21 dorëzuar më parë -- ka parashtruar më parë se kërkime të
22 mëtejshme të synuara për material shfajësues janë të
23 nevojshme.

24 Mbrojtja e Krasniqi është e mendimit që nxjerrja
25 shfajësuese nuk mund të vonohet, nuk mund të shtyhet për më

1 tepër dhe i kërkon ZPS-së që të kryejë kontrollimet shtesë, sa
2 më shpejt që të jetë e mundur.

3 Së pari do t'ja jap fjalën Mbrojtjes së Krasniqit lidhur
4 me këtë kërkesë.

5 Ju kujtoj gjithashtu palëve që kërkesat e tjera të
6 dorëzuara nga Mbrojtjet, lidhur me materialin sipas rregullës
7 103, do të trajtohen në vendim me shkrim, kështu që ne nuk do
8 t'i diskutojmë këto kërkesa në seancën e ditës së sonte.

9 Së pari, i drejtohem znj. Alagendra. Nuk e di në qoftë se
10 doni që ta merrni ju fjalën apo z. Ellis.

11 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Z.
12 Ellis, ju lutem.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E keni fjalën ju, z. Ellis.

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Kjo nuk ishte një kërkesë për
15 kontrollime shtesë nga ZPS-ja, por kontrollime të cilat janë
16 treguar nga ZPS-ja që janë në vijim e sipër.

17 Pikënisja për këtë ka ardhur nga parashtrimi i bërë nga
18 Prokuroria në Konferencën për Ecurinë e Çështjes më 24 mars
19 2022. Parashtrimi i bërë nga Prokuroria atje në faqen 1089,
20 ishte që përveç rishikimit, dokument pas dokument, Prokuroria
21 po organizonte kontrollime të synuara dhe këto ishin masa
22 shtesë për të siguruar që ishte nxjerrë i gjithë materiali i
23 nevojshëm dhe që do të informonte Gjykatën për progresin e
24 bërë.

25 Ndërkohë më pas në faqen 1107, Prokuroria konfirmoi që

1 kontrollimet e synuara ishin filluar në përputhje me
2 përfundimin e listave të dëshmitarëve dhe të provave.

3 Pozicioni ynë është ky, ka qenë shumë e qartë se përveç
4 rishikimit të analizës, pra ka pasur një proces të ndryshëm të
5 kontrollimit të etiketuar dhe këto janë lidhur me listat e
6 provave materiale dhe dëshmitarëve.

7 Në qoftë se kjo është situata e vërtetë, atëherë ne duam
8 që të kemi një afat për rezultatet e këtyre kontrollimeve të
9 synuara. Dhe këto janë kontrollime të cilat janë në proces e
10 sipër, gjë të cilën ne e dimë se na e ka thënë vetë Prokuroria
11 dhe të paktën ky është një proces që ka filluar që prej marsit
12 2022.

13 Dhe ajo për të cilën ne duam që t'i dalim situatës më
14 përpara është që nxjerrja e materiale shfajësuese është një
15 detyrim i vazhdueshëm për Prokuror, kështu që Prokuror nuk
16 duhet t'i bëjë bisht detyrimit për të nxjerrë material
17 shfajësues menjëherë në momentin kur Prokuroria e ka një
18 dokumentacion të tillë në duar.

19 Ne sugjerojmë që, përveçse ta lidhim atë me kontrollime
20 të tjera shtesë të synuara ajo farë kërkojmë ne është që
21 kontrollimet e synuara të cilat i ka përmendur Prokuroria, pra
22 ato të cilat lidhen drejtpërdrejtë me listën e dëshmitarëve
23 dhe listën e prova materiale, pra, në qoftë se këto
24 kontrollime lidhen me materiale shfajësuese, duhet që
25 materialet shfajësues të na vihen në dispozicion menjëherë.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Ellis.

2 A ka ndonjë ekip tjetër Mbrojtja që dëshiron që të shtojë
3 diçka tjetër lidhur me atë çfarë tha z. Ellis.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Ne sigurisht që e mbështesim
5 kërkesën e z. Krasniqi në emër të Presidentit Thaçi. Kemi edhe
6 disa çështje të tjera të cilat bien nën rregullën 103
7 megjithatë do t'i shprehim pak më pas.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. O'Reilly.

9 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne kemi
10 nxjerrë -- kemi ngritur të njëjtin shqetësim edhe në çështjen
11 dhe në parashtrimet që kemi bërë për Konferencën e fundit për
12 Ecurinë e Çështjes.

13 I vetmi ndryshim i vogël me Mbrojtjen e Krasniqit është
14 që besoj që ata pretendojnë -- pra, kanë propozuar 30
15 shtatorin për afatin për dosjen paraprake, ndërkohë që dosja
16 paraprake duhet të dorëzohet me 30 tetor.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. Young.

19 Z. YOUNG: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar, e
20 mbështesim plotësisht parashtrimin.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Le të vazhdojmë me
22 Prokurorinë.

23 Z. Prokuror.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

25 Në këtë çështje Mbrojtja po e keqpërfaqëson natyrën e

1 detyrimit sipas rregullit 103. Ata funksionojnë mbi të njëjtin
2 keqinterpretim që kanë përdorur edhe në Konferencën e fundit
3 për Ecurinë e Çështje edhe kjo tregohet edhe nga citimi që
4 bëri z. Ellis, pra në faqen 1245 të transkriptit.

5 Dhe ajo çfarë thuhet në seancë është që:

6 "Në kontrollimet e synuara nuk është se ka një fazë
7 fillestare të rishikimit dhe fazës së kontrollimit të synuar
8 dhe kjo ka të bëjë me vigjilencën."

9 Të njëjtin pozicion e kemi edhe sot teksa flasim. Siç e
10 thatë edhe ju i nderuar Gjykatës ne kemi afatin për nxjerrjen
11 e materialeve deri më 16 qershor 2022.

12 Çdo diskutim tjetër që ka të bëjë me kontrollimet e
13 synuara keqpërfaqëson atë çfarë ne e quajmë ose atë çfarë
14 nënkuptojmë ne me kontrollime të tilla. Ne po vazhdomë në
15 përputhje me udhëzimet e dhëna prej jush, i nderuar Gjykatës,
16 dhe ky është një detyrim i vazhdueshëm.

17 Në fund të ditës, Mbrojtja nuk duhet të dijë -- të ketë
18 një datë përfundimtare sa i takon kontrollimeve për qëllime të
19 materialeve të rregullit 103. Kontrollimet janë duke u kryer,
20 mund të ribëhen kontrollime të reja, mund të duhet që të bëhen
21 gjatë procedura

22 Dhe ajo çfarë është e rëndësishme është që çdo gjë që
23 është bërë të etiketohet siç duhet dhe nuk është në interes të
24 askujt që përpjekjet e ZPS-së të kufizohen në këtë aspekt.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Më lejoni të bëj disa

1 pyetje. E kuptoj qasjen tuaj, por e kuptoj edhe qasjen e
2 Mbrojtjes, që ata nuk duan që Prokuroria të përdorë këtë gjë
3 për të nxjerrë në një fazë më të vonë dokumente që cilat duhej
4 t'i kishit nxjerrë më përpara. Sigurisht që është gjithmonë në
5 interes të Mbrojtjes që të marrë material shfajësues edhe në
6 qoftë se kjo ndodh në një fazë të mëvonshme. Megjithatë në
7 vetvete kjo nuk ju pengon juve që të bëni nxjerrjen më
8 përpara. Mendoj që kjo është çështja thelbësore.

9 Dhe elementi i dytë që dua të ngre është që: A mendoni që
10 e keni përmbushur detyrimin që keni? Pra, me fjalë të tjera, a
11 e keni rishikuar të gjitha dokumentet për material shfajësues
12 apo mendoni se kjo është një detyrë e cila nuk është
13 përfunduar dhe nuk mund të përfundojë derisa ju të bëni këto
14 kontrollime të tjera konkrete të cilat juve i mendoni si pjesë
15 e përgjegjësisë tuaj? Kjo është pjesa kryesore.

16 Dhe pastaj, plotësuese, është çështja që në qoftë se ju
17 nxirrni një dokument që nuk e keni identifikuar më përpara po
18 ky nuk ka qenë pozicioni juaj -- por nuk e keni pasur këtë
19 dokument më përpara a e konsideroni këtë si shkelje të
20 nxjerrjes apo jo? Sepse në fund të ditës këtë gjë po vë në
21 diskutim Mbrojtja këtu.

22 Z. HALLING: [Përkthim] E kuptova. Më lejoni t'i marr të
23 gjitha çështjet njëra pas tjetrës.

24 Së pari, ne pra, duket sikur Mbrojtja mendon që neve po i
25 bëjmë bisht detyrimeve sipas rregullës 103. Dhe situata nuk

1 është kjo. Ne e kemi bërë rishikimin sipas rregullës 103. Ne e
2 kemi bërë rishikimin për çdo material në koleksionin tonë dhe
3 ne do ta bëjmë, domethënë, e kemi bërë këtë deri më 16 qershor
4 2022.

5 Ne i kemi përmbushur detyrimet për nxjerrjen e materialit
6 sipas rregullës 103. Ne kemi parasysh se shumë gjëra mund të
7 ndodhin, materialet mund të vlerësohen, procedurat mund të
8 zhvillohen, mund të evoluojnë më tepër dhe ne kemi krijuar një
9 sistem në mënyrë të tillë që të sigurohemi që të kemi analizim
10 të vazhdueshëm të koleksionit të dokumenteve që kemi në
11 dispozicion dhe sigurisht që do të përmbushim detyrimet e
12 rregullës 103.

13 Siç e thamë në Konferencën e fundit për Ecurinë e
14 Çështjes kjo nuk do të thotë që nuk do të ketë më nxjerrje
15 sipas materialit 103, për materiale më të vjetra. Por, që nga
16 e Konferenca e fundit për Ecurinë e Çështjes deri më sot , në
17 fakt janë bërë disa rivlerësime dhe sipas parashtrimit tonë,
18 pra, ky është një shteg i zakonshëm, mënyrë e zakonshme e
19 funksionimit të mirë të një zyre të Prokurorisë. Ne do ta
20 vazhdojmë këtë proces, gjatë të gjithë procedurës. Nuk ka
21 arsye se pse të ndërpritet ky proces dhe nuk ka arsye se pse
22 të përcaktohet një afat kohor artificial për diçka të cilat ne
23 jemi të detyruar që t'i nxjerrim.

24 Për sa i takon pyetjes së fundit, i nderuar Gjykatës, që
25 lidhet me nxjerrjen e vonuar të dokumenteve, gjë e cila mund

1 të çonte në shkelje të nxjerrjes, ne nuk mendojmë se ky është
2 domosdoshmërisht interpretimi. Në qoftë se ka dokumente të
3 cilat duhet të nxirren sipas rregullës 102(3) dhe në qoftë se
4 Mbrojtja mendon që ka vonesa, do të ishte mirë që Mbrojtja
5 t'ju drejtohej juve, i nderuar Gjykatës, për një mënyrë për të
6 zgjidhur situatën më shumë se sa të etiketonte kontrollin e
7 etiketuar dhe gjithashtu edhe afatet kohore.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se mund të
10 përgjigjem shkurtimisht. Ndoshta Prokurori nuk është i njohur
11 me procedurat e mëparshme në këtë aspekt.

12 Por vigjilenca lidhur me materialet për rregullin 103 nuk
13 është një qëndrim i duhur ose një fjalë e duhur që mund të
14 përdorej për përshkrimin e zyrës së ZPS-së kur flitet për
15 nxjerrjen sipas materialit të 103-it.

16 Ne jemi disa -- jemi 6 muaj që flasim për materialin që
17 duhet nxjerrë sipas rregullit 103, kështu që fjala
18 "vigjilencë" është një ndajfolje, është një fjalë, është një
19 emër që nuk është etiketimi i duhur për të përshkruar
20 përpjekjet e ZPS-së në këtë aspekt.

21 Ju lutem, shikoni se çfarë kanë të drejtë të bëjnë ata
22 dhe, i nderuar Gjykatës, ju e keni vënë re këtë në shumë
23 raste. Materiali sipas rregullës 103 duhet që të dorëzohet
24 menjëherë jo kur t'i kërkohet, por duhet që të dorëzohet
25 "menjëherë" dhe menjëherë do të thotë tani.

1 Në fakt z. Gjykatës, juve e thatë edhe më përpara që
2 fjala "menjëherë" do të thotë tani.

3 Kështu që të bësh tjerrje të kontrollimeve të etiketuara
4 që duhen nxirren sipas rregullës 103 është pa vlerë. Pra, kjo
5 në vetvete përcakton dhe është treguesi i përpjekjeve që ka
6 bërë ZPS-ja deri tani. Kur ZPS-ja vendoset në pozitë të
7 vështirë atëherë ata dorëzojnë material shfajësues.

8 Është shumë e thjeshtë. Kjo është një çështje e cila ka
9 hasur shumë probleme nga ana e Prokurorisë, ka dokumente
10 shfajësuese në posedim, në zotërim të ZPS-së, aktualisht. Duke
11 lënë mënjanë mocionin që kemi dorëzuar sot, lidhur me
12 dokumentet serbe, të cilat ju e keni parë, i nderuar Gjykatës.

13 Pra ky është një proces që duhet bërë dhe bëhet mirë, që
14 të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Ata duhet ta bëjnë
15 dorëzimin e këtyre materialeve tani. Pra, kolegu im thotë "le
16 ta shtyjmë më andej" dhe, i nderuar Gjykatës, kjo do të thotë
17 sipas atyre që ta çojmë këtë çështje deri në gjykim.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Kehoe.

19 Z. Ellis.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Shkurtimisht.

21 Më lejoni të them që nuk po flas për kontrollime të reja.
22 Neve e vlerësojmë që kur linja e re e Mbrojtjes të bëhet e
23 dukshme për Prokurorinë, atëherë të na jepen materialet
24 përkatëse. Por, megjithatë unë nuk po flas për këtë gjë, kur
25 kërkova nxjerrjen e materialeve përkatëse.

1 Unë po flas për kategorinë konkrete të kontrolleve të
2 synuara për listën e dëshmitarëve dhe listën e prova materiale
3 të cilat ne na u tha që në mars që vijon. Në qoftë se ata
4 thonë që kontrollimet kanë filluar që nga marsi, atëherë pse
5 ka kaq shumë rezistencë nga Prokuroria që ne kërkojmë që të
6 përcaktohet një afat nga ju, i nderuar Gjykatës, lidhur me
7 këto kontrollime.

8 Ajo çfarë duam të shmangim në këtë rast, është një
9 situatë që ka ndodhur shpeshherë në tribunalë të tjerë, që
10 duhet pritur deri pak para dëshmitarëve -- të dëshmime të
11 dëshmitarëve se sa të marrim informacionin që ka të bëjë me
12 kontrollet. Ne thjesht duam t'i dalim përpara kësaj gjëje.

13 Dhe sinqerisht nuk e kuptojmë përse kundërshton
14 Prokuroria që të na e japë këtë material.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Ellis.

16 Me sa e kuptoj unë, ZPS-ja mendon se e ka përfunduar
17 kontrollimin e saj për material shfajësuese. Në qoftë se ju e
18 quani atë përmes kontrollimeve specifike shtesë, por z.
19 Prokuror, ju na thatë që kjo është bërë. Kështu që ajo çfarë
20 po përmend z. Ellis, këto kontrollimet shtesë ju i keni
21 përfunduar gjatë rishikimit, analizës? Por kur flisnim për
22 kontrollimin shtesë, nuk i referoheni dokumenteve që i keni
23 kaluar, analizuar akoma; e kam të saktë këtë e kam kuptuar
24 drejtë?

25 Z. HALLING: [Përkthim] Do të thoja po, mënyrën se si e

1 përshkruat. Dallimi që bëjmë ne është rishikimi analizimit të
2 dokumenteve nën rregullin 103 që është që shikojmë dokumente
3 të reja ndërkohë që ato na vijnë në zotërimin tonë dhe kemi
4 edhe kontrollimet e etiketuar të cilat kanë të bëjmë me diçka
5 konkrete.

6 Për argumentin e ngritur nga z. Ellis, për kontrollimet e
7 etiketuara të cilat çojnë në material sipas rregullës 103, ky
8 material nxirret menjëherë. Ne nuk presim kohë që të kalojë,
9 por këto material i nxjerrim përnjëherë.

10 Megjithatë, kjo është arsyeja se pse po themi që pasja e
11 një afati arbitrar në vetvete nuk është se do të ndryshojmë
12 sjellën tonë prandaj ne mendojmë që përcaktimi i një afati nuk
13 është i nevojshëm.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. Ellis.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk ka dyshim që jam i ngadalshëm
17 këtë pasdite. Prokuroria a ka përfunduar kontrollimet e
18 etiketuar lidhur me listat e dëshmitarëve dhe listat e provave
19 materiale që ka përmendur në Konferencë për Ecurinë e Çështjes
20 në mars? Akoma nuk kam marrë përgjigje për këtë pyetje.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Halling, ju lutem jepini
22 një pyetje [sipas përkthimit] z. Ellis.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Çdo kontrollim i synuar që kemi
24 përfunduar që prej marsit, të gjitha materialet nën rregullin
25 103 janë nxjerrë. Në momentin në mars kur të gjitha këto

1 kontrollime të synuara janë diskutuar, disa prej tyre dhe
2 çështje të tjera kanë dalë për gjëra të komplikuar. Kështu që
3 dua të them që çdo gjë që është bërë që prej marsit për
4 kontrollimet e etiketuar përshirë këtu edhe dëshmitarët edhe
5 listat materiale të veçanta është nxjerrë sipas rregullës 103.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] A mendoni se nevojiten
7 kontrollime të tjera shtesë të synuara për të përmbushur
8 detyrimet për detyrim [sipas përkthimit]?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Arsyeja pse përgjigja është
10 "po" është se kemi të bëjmë me një proces të vazhdueshëm dhe
11 duhet që të sigurohemi që detyrimet tona janë të përditësuara
12 dhe të plotësuara në çdo moment.

13 Pra nuk është se kontrollimet e etiketuara na nevojiten
14 ne për -- me një afat të caktuar.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk ju kuptoj, z. Prokuror.

16 Besoj që duhet të bëjmë një dallim ndërmjet materialeve
17 të ndryshme shfajësuese. Pra, nga njëra anë kemi materiale të
18 cilat juve do t' i merrni pas afatit të qershorit. Për këto
19 materiale duhet që të bëni kontrollime sepse këto janë
20 materiale të reja. Këto i lëmë mënjanë.

21 Pastaj, nga ana tjetër, kemi materiale të cilat ju i
22 keni, por që mund të bëhen shfajësues, sepse siç e tha edhe z.
23 Rees [sipas përkthimit] mund të ketë një arsyetim të ri ose
24 mund të ketë informacion të ri ose mund të ketë gjëra të cilat
25 mund të jenë konsideruar shfajësuese, mund të bëhen fajësuese.

1 Dhe në kohën e momentit të analizës fillestare, domethënë, ju
2 nuk i keni menduar këto materiale si shfajësuese, por ndërkohë
3 tani dalin shfajësuese.

4 Ajo çfarë nuk kuptoj unë tani është që ajo çfarë duhet të
5 konsiderohet shfajësuese tani, pra nuk e kuptoj se pse
6 kontrollime të tilla të etiketuara nuk mund të realizohen
7 tani. Në qoftë se është e qartë që kemi të bëjmë me material
8 shfajësues tani, duhet të nxirret. Kaq. Pikë.

9 Pra, mënyra se si e bëni ju procesin është puna juaj.
10 Mbrojtja nuk ka të bëjë fare me këtë gjë. Por, Mbrojtja duhet
11 të marrë atë që ka të drejtë që të marrë. Pra, duhet të marrë
12 materialin shfajësues. Pra, i lashë mënjanë dy kategoritë që
13 identifikova më përpara sepse mendoj se kjo është një çështje
14 e veçantë.

15 Megjithatë ajo për të cilën jam i shqetësuar tani është
16 që, kur thoni që "duhet të bëhen kontrole të tjera shtesë", a
17 do të thotë kjo që nuk e keni përfunduar punën? Këtë nuk e
18 kuptoj.

19 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, më mirë të
20 marrim një rast hipotetik me një dëshmitar të caktuar.

21 Në këtë moment, çdo dëshmitar, si Dëshmitari 1 hipotetik,
22 që ka material të rregullës 103, ai material i është dhënë
23 Mbrojtjes ose është në një mocion për masa mbrojtëse. Statusi
24 i atyre është i zgjidhur. Në këtë moment ne nuk kemi ndonjë
25 material tjetër që dimë që duhet t'i jepet Mbrojtjes në lidhje

1 me Dëshmitarin 1 në bazë të rregullës 103. Dhe kjo është e
2 vërtetë për çdo dëshmitar.

3 Pyetja është se çfarë do të ndodhi në qoftë se ne i
4 shikojmë materialet që kemi para vetes përpara dhe aty shohim
5 që ka informacionin, statusi i të cilave mund të ndryshojë, në
6 lidhje me Dëshmitarin 1. Për shembull, mund të kuptojmë që një
7 material ose një informacion mund të konsiderohet tashi
8 shfajësues. Dhe këtë, në ato moment, ne ja japim menjëherë
9 Mbrojtjes. Dhe kjo do të kapej ndërmjet një kërkimi të synuar
10 në material, për këto materiale apo informacione.

11 Pra, nuk është se ka informacione për dëshmitarë të
12 caktuar në rregullën - sipas rregullës 103, për të cilët ne
13 kemi informacion dhe nuk po e japim, por ne jemi në proces të
14 shqyrtimit të materialit nëse mund të kapim materiale
15 shfajësuese në të ardhmen.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Edhe një herë, nuk po them
17 që të mos t'i bëni këto kërkime të synuara për kategoritë që
18 përmenda përpara, por dua të shoh nxjerrje të materialeve që
19 ju i konsideroni papritur se tani janë shfajësuese. Por, që ka
20 qenë shfajësuese edhe gjashtë muaj përpara, përse nuk nxirren
21 këto?

22 A e kuptoni se çfarë po them? Pra, në qoftë se ka një
23 arsyetim të ri nga Mbrojtja apo ka mënyrë të re të shikimit të
24 gjërave që ndryshon mënyra se si e shikoni ju dëshminë e
25 dëshmitarit, e kuptoj atë që po bëni. Por, në qoftë se ky

1 material ka ekzistuar përpara nuk ka justifikim. Ai duhet të
2 nxirret.

3 Ju nuk keni *carte blanche* për të rivlerësuar sa herë të
4 doni, në qoftë se ju e keni konsideruar që ky ka qenë material
5 shfajësues përpara afatit të mëparshëm, atëherë nuk e kuptoj
6 përse mos ta dorëzoni në një fazë të mëvonshme. A më kuptoni
7 se çfarë po them?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Po kjo pyetje është ndryshe. Kjo
9 ka të bëjë me cilësinë e shqyrtimit tonë mbi bazën e rregullës
10 103. Dhe nuk ka të bëjë me kërkimet e synuara, por ka të bëjë
11 nëse nxjerrja e materialeve sipas rregullës 103 është e
12 justifikuar apo jo.

13 Dhe kjo ka të bëjë me atë që ne duhet t'i përgjigjemi një
14 standardi të caktuar rast pas rasti, ashtu siç tha z. Kehoe.
15 Por, ne besojmë që ne mund të na kërkohet llogari, në lidhje
16 me nxjerrjet në bazë të rregullës 103. Por ka asnjë dokument
17 në bazë të rregullës 103, që tashmë nuk është nxjerrë ose që
18 nuk është proces debati ligjor këtu para jush.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

20 Z. Kehoe.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Shumë shkurtimisht. A është
22 përgjigje kjo për pyetjen tuaj? Pyetja juaj ishte se: Kur do
23 ta nxirrni këtë material nga këto kërkimet -- mbas këtyre
24 kërkimeve të synuara: Po mua më duket se përgjigja nuk i është
25 dhënë pyetjes tuaj.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mua më duket se ZPS-ja
2 mendon që detyrimi i saj në lidhje me rregullën 103 është
3 kryer, por këto kërkimet e synuara do të zhvillohen vetëm për
4 materiale të cilat më përpara nuk janë konsideruar në mënyrë
5 legjitime si shfajësuese. Ata kur kanë bërë shqyrtimin e parë
6 dhe pasi kanë bërë këtë kërkim të synuar dhe mbas afateve të
7 caktuara, ata -- atyre mund t'i kërkohet llogari, në qoftë se
8 nuk i kanë nxjerrë këto materiale.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Ajo fjala kyçe këtu është
10 "llogaridhënia" dhe Prokuroria po përpiqet që të shfajësojë
11 veten nga çdo gjë edhe po thonë që "Oh po në shqyrtimin e parë
12 ne nuk e gjetëm, këto nuk i pamë këto dhe po përpiqemi të
13 gjejmë, domethënë, ky është një material që sapo e gjetëm
14 tani". Por, megjithatë, kjo na lë ne në një pozitë kur pyetja
15 e avokatit të z. Krasniqi nuk ka marrë përgjigje. A do të
16 bëhet kjo? A do të bëhet kjo tani?

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Kehoe.

18 Z. Prokuror keni diçka për të thënë?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Jo s'kam gjë për të shtuar.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

21 Tani të kalojmë tek material i rregullës 102(3). I kujtoj
22 palët se në Konferencën e fundit me 20 maj 202, unë urdhërova
23 ZPS-në në lidhje me kërkesat ende të patrajtuara të Mbrojtjes
24 për materialet e rregullës 102(3), së pari, për të finalizuar
25 përpunimin e këtyre kërkesave; së dyti të kërkojë masa

1 mbrojtëse apo të bëjë kundërshtime të rëndësisë materiale të
2 këtyre materialeve; dhe së treti të nxjerrë të gjithë
3 materialet të cilat nuk janë objekt i kërkesave për masa
4 mbrojtëse apo kundërshtime deri më 30 shtator 2022.

5 Që nga konferenca e fundit, ZPS-ja ka thënë se ka
6 dorëzuar mbi 45,000 dokumente apo materiale të rregullës
7 102(3) në përgjigje të kërkesave të Mbrojtjes.

8 Sipas ZPS-së rreth 65% e numrit të përgjithshëm të
9 materialeve të rregullës 102(3) tashmë janë zgjidhur. Pra,
10 kanë marrë përgjigje. ZPS-ja ka thënë gjithashtu që kërkesat
11 ose kundërshtimet e rëndësisë materiale dhe kërkesat për masa
12 mbrojtëse do të jenë të nevojshme për disa kërkesa në bazë të
13 rregullës 102(3) në të ardhmen.

14 ZPS-ja gjithashtu tha që do të përmbushë, do t'i kryejë
15 këto brenda afatit të 30 shtatorit 2022, si për ato materiale
16 që janë zgjedhur nga njoftimi i rregullës 102(3) deri në ditën
17 e -- që ishin zgjedhur nga njoftimi i rregullës 102(3) në
18 Konferencën e fundit dhe të gjithë kundërshtimet apo masat
19 mbrojtëse që do të kërkohen.

20 Thaçi ka thënë se ka bërë tre kërkesa të tjera të
21 kufizuara që kanë të bëjmë me 80 dokument. Po kështu ajo
22 mbetet e shqetësuar për sa i përket vonësive në dhënien e
23 materialeve dhe kërkesave që ZPS-ja vazhdon t'i nxjerrë të
24 gjitha -- dhe bën kërkesën që ZPS-ja t'i nxjerrë të gjithë
25 materialet në vijimësi.

1 Mbrojtja e Thaçit gjithashtu tha që ka ndërmend që të
2 bëjë kërkesa të tjera për materiale të rregullës 102(3).

3 Mbrojtja e Veselit tha se i ka dorëzuar kërkesat e veta
4 për material të rregullës 102(3) me 22 qershor 2022. Tha që
5 kanë mbetur vetëm 263 dokumenta nga të cilat i ka kërkuar ajo,
6 nuk janë kërkuar nga ekipet e tjera të Mbrojtjes.

7 Dhe e ftoj ZPS-në të na thotë nëse mund t'i nxjerrë këto
8 materiale deri më 3 shtator.

9 Po kështu Mbrojtja e Veselit tha se nuk ka marrë një
10 njoftim të përditësuar të rregullës 102(3) dhe e ftoj ZPS-në
11 që të sqarojë se çfarë ka ndërmend të bëjë në lidhje me këtë
12 çështje.

13 Mbrojtja e Selimit tha se ka marrë më shumë se gjysmën e
14 dokumenteve që ka kërkuar, por në një mënyrë kaotike dhe jo të
15 qëndrueshme. Kjo sepse numrat e këtyre dokument mungonin dhe
16 nuk ka tabela të konsoliduara për kalendarin e nxjerrjes së
17 këtyre dokumenteve. Mbrojtja e Selimit është gjithashtu e
18 shqetësuar se do të vërshojnë kërkesat për masa mbrojtëse apo
19 kundërshtimet ndaj materialitetit mu përpara skadimit të
20 afatit të rregullës 102(3). Gjithashtu ka shqetësim se do të
21 duhet t'i përgjigjet këtyre kërkesave në të njëjtën kohë që
22 duhet të bëjë edhe të përfundojë edhe dosjen e vet paraprake
23 që është data -- duhet të dorëzohet me datën 21 tetor 2022.

24 Mbrojtja e Selimit kërkon që të bëhet një tabelë me të
25 gjitha referencat materialeve të nxjerra dhe si përputhen ato

1 me listën 102 -- e rregullës 102(3); që ZPS-ja t'i japi
2 prioritet kërkesave për masa mbrojtëse apo kundërshtimeve për
3 rëndësinë materiale të dokumenteve, deri me 26 gusht, më së
4 voni; përgjigjet e Mbrojtjes të jepen deri më 16 shtator dhe
5 vendimet nga Gjykatësi për këto kërkesa të jepen deri me 30
6 shtator 2022.

7 Dhe ju ftoj që t'i përgjigjeni këtyre kërkesave nga
8 Mbrojtja e Selimit.

9 Po kështu, që Mbrojtja e Krasniqit ka thënë që ende po
10 pret 25,000 dokumente që t'i nxirren. Ajo kërkon që ZPS-ja të
11 angazhohet me Mbrojtjen, në lidhje me çështjet e rëndësisë
12 materiale dhe masave mbrojtëse, paraprakisht në kohë,
13 domethënë, shumë më përpara afatit të 30 shtatorit, në mënyrë
14 që të bëhen diskutime të njëmendta midis palëve në lidhje me
15 këto çështje dhe të mos pengohet procedura.

16 Tani do t'i jap fjalën Prokurorit që t'i trajtojë të
17 gjitha këto kërkesa të Mbrojtjes.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Do të parashtroj
19 këtu në lidhje me të gjitha kërkesat që u bënë dhe pikat që u
20 ngritën.

21 Siç shihet numrat dhe shifrat që kemi dhënë ne e kemi
22 përshpejtuar nxjerrjet që nga Konferenca e fundit për Ecurinë
23 e Çështjesh. Kjo është një detyrë që është kryer përmes
24 angazhimit të gjithë stafit të ZPS-së që të punojë me
25 materialet në këtë çështje.

1 Këto burime që kemi përdorur na bënë që ne të jemi në
2 gjendje t'i bëjmë -- t'i plotësojmë afatet, por kjo kërkon
3 shumë burime njerëzore dhe burime të tjera. Dhe kjo nuk ka të
4 bëjë me -- domethënë nuk përfshin edhe detyrat e tjera që ka
5 Prokuroria, për shembull, kthimin e përgjigjeve që kemi
6 diskutuar, e të tjerë.

7 Por për t'ju përmbajtur këtij afati, është që -- është e
8 rëndësishme që detyrimet tona të mbeten ashtu siç kanë qenë.
9 Dhe kjo ka të bëjë edhe me atë që kërkoi Mbrojtja e z. Selimi,
10 duke shtuar edhe 263 kërkesa të tjera, materiale të tjera.

11 Masat mbrojtëse që keni përcaktuar ju, i nderuar
12 Gjykatës, disa javë përpara, këto duhet të dorëzoheshin siç e
13 thatë ju deri me 30 shtator. Nuk ka ndodhur asgjë nga ajo kohë
14 e deri tani, këto shtatë javë, që mund ta justifikojnë
15 ndryshimin e këtij afati. Ne do t'i bëjmë nxjerrjet në
16 vijimësi dhe sigurisht do të kemi korrespondencë me Mbrojtjen
17 në lidhje me ndonjë kundërshtim që kemi për rëndësinë
18 materiale të dokumenteve.

19 Për këto 263 materiale që ka kërkuar Mbrojtja e Veselit,
20 ky është një shembull tjetër i rishqyrtimit tonë. Veseli e
21 keqkarakterizon natyrën e kërkesës që bënë ata në 22 qershor
22 2022. Ata nuk e përmendën këtë numër në parashtrimin e tyre.
23 Veseli kërkoi 23,000 dokumente nga njoftimi i rregullës
24 102(3).

25 Sigurisht që ka mbivendosje midis atyre që kërkohen

1 atëherë dhe atyre që -- atyre dokumenteve që janë dhënë dhe
2 atyre që kërkohen deri me 30 shtator. Por, z. Veseli dhe
3 Mbrojtja e tij nuk japin specifika dhe ja lënë ZPS-së që të
4 bëjë përputhjen midis kërkesës së tyre dhe çfarë ka Prokuroria
5 dhe të shohë nëse ky numër është 263.

6 Por, kur Veseli thotë në paragrafin 2 të parashtrimeve të
7 veta, që ka marrë vetëm 19,000 nga 54,000 dokumente që ka
8 kërkuar, ata numërojnë edhe 23,000 dokumentet që i kanë
9 kërkuar pas afatit që ishte caktuar.

10 Për sa i përket listës relevante të përditësuar. Duhet --
11 ky është një detyrim që do të vazhdojë gjatë gjithë
12 procedurës. Përgatitja e kësaj liste është e ndryshme për nga
13 natyra, nga ajo që kërkon urdhri, sipas rregullës 109. Është
14 një projekt që kërkon shumë kohë dhe shumë njerëz, shumë
15 kapacitete njerëzore dhe të gjithë këta njerëz janë kritikë
16 edhe për të bërë punën që kërkohet që të dorëzohet deri me 30
17 shtator. Nuk është thjesht çështje që është një listë ERN-sh,
18 numra të regjistrimit të provave, por duhet shkruar një
19 përshkrim për secilin dokument dhe ky përshkrim duhet të jetë
20 mjaftueshmërisht i plotë që t'i përmbushi kushtet e rregullës
21 102(3), por nuk duhet të jetë aq i hollësishëm sa që të
22 komprometojë masa mbrojtëse. Dhe prandaj kërkohet që ne t'i
23 shqyrtojmë, t'i rishikojmë edhe një herë këto dokumenta.

24 Dhe si rezultat i kësaj, ky afati i 30 shtatorit që u
25 caktuar në Konferencën e 12-të, është që ZPS-ja të lejohet të

1 dorëzojë materiale të zgjedhura edhe pas -- e zgjedhura edhe
2 pas majit të 2022 edhe pas 30 shtatorit.

3 Pra, ZPS-ja propozon që të dorëzojë një listë të
4 materialeve relevante të përditësuar pas 30 shtatorit, në
5 mënyrë që të bëjë përkimin e këtyre materialeve për nga numrat
6 dhe referencat. ZPS-ja pastaj do ta bëjë këtë punë në mënyrë
7 të përshpejtuar.

8 Për sa i përket tabelave. Këtë e shikoni edhe në
9 parashtrimet që ka bërë Mbrojtja në lidhje me emaillet që ka
10 dërguar ZPS-ja. Parashtrimet e ZPS-së në lidhje me emaillet e
11 Mbrojtjes për kërkesë për informacion shkojnë përtej
12 detyrimeve statutore të ZPS-së. ZPS-ja bën nxjerrjet, jep
13 metadatat, në bazë të të gjitha politikave dhe protokolleve.

14 Dhe Mbrojtja mund të dojë informacion plus që të
15 shoqërojë këto nxjerrje të këtyre materialeve. Dhe Prokuroria
16 ka premtuar që mund të japi informacion tjetër. Por këto hapa
17 duhet të jenë dytësore ndaj afatit që na është caktuar për ato
18 që po bëjmë tani.

19 Edhe Mbrojtja duhet ta pranojë që me gjithë kërkesat e
20 jashtëzakonshme që ka dhe punën e jashtëzakonshme që ka ZPS-
21 ja, ne i jemi përmbajtur afateve tona.

22 Kaq kam për të thënë për këtë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Përpara se t'ja jap fjalën
24 Mbrojtjes, një pyetje në lidhje me dokumentet që janë kërkuar
25 nga Mbrojtja e Veselit.

1 A i kërkon shumë kohë ZPS-së që t'i nxjerrë dokumentet që
2 tashmë janë kërkuar edhe nga ekipet e tjera të Mbrojtja sepse
3 janë 263 dokument apo një X numër dokumentesh për të cilët
4 juve duhet të bëni një rishikim apo shqyrtim tjetër. Por, për
5 dokumente të cilat i janë Mbrojtjeve të tjera nuk besoj që kjo
6 do t'ju kushtojë shumë kohë.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk e keni gabim, i nderuar
8 Gjykatës, por ne duhet ta themi sinqerisht se parashtrimi jonë
9 për Mbrojtjen e Veselit ishte se ata e keqparaqitën numrin e
10 dokumenteve që i kishim dhënë atyre. Nuk është -- nuk do të na
11 kërkojë shumë kohë t'i nxjerrim përsëri këto dokument që i
12 janë Mbrojtjeve të tjera dhe atyre.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Por, në qoftë se ekipi i
14 Veselit mund të marri rreth 21,000 dokumente, ky është një
15 përmirësim shumë i madh. Kjo do të ishte një demonstrim i madh
16 nga juaj për gatishmërinë që të ndihmoni Mbrojtjen të
17 përgatisin çështjen e tyre.

18 Z. HALLING: [Përkthim] E kuptoj se ku doni të dilni me
19 këtë. Ne do të përpiqemi ta bëjmë këtë brenda 30 shatorit.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Sa për t'i vendosur të gjitha këto
22 në kontekst. Po flasim për nxjerrjen e materialeve në bazë të
23 rregullës 102(3) dhe ne nuk kemi kundërshtim për afatin 30
24 shtator, por po flasim për nxjerrjen e dokumenteve deri me 30
25 shtator, kur Prokuroria ka thënë që ishin gati për gjykim që

1 në maj të 2021, më shumë se një vit e ca më përpara.

2 Ajo që po kërkojmë dhe secili nga kolegët e mi flet për
3 klientin e vet, ne kërkojmë një lloj nxjerrjeje në vijimësi,
4 sa herë që mbaron një grup dokument, apo shikon diçka, apo ke
5 një kundërshtim në lidhje me rëndësinë materiale, përse të mos
6 e dorëzosh tani, përse të mos ta bësh tani, në mënyrë që ta
7 trajtojmë tani, në vend që të marrim një tufë dokumentesh apo
8 një tufë kërkesash në fund të shtatorit dhe të merrmi me ato
9 atëherë.

10 Duhet të jemi -- do të ishte më e udhës që këto dokumente
11 të jepeshin tani në mënyrë -- në vijimësi, sa herë që të jenë
12 gati dhe të jemi gati, domethënë të shkojmë drejt procesit të
13 gjyqimit. Kaq, ky është propozimi ynë i thjeshtë që kërkojnë
14 edhe kolegët e mi.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson, apo znj.
16 O'Reilly?

17 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Në lidhje me 263 dokumentet,
18 duket se Prokuroria nuk është në gjendje ta konfirmojë këtë
19 shifër. S'po e kuptoj. Sepse janë dokumente të cilat i janë
20 nxjerrë ekipeve të tjera dhe në qoftë se do t'i ndihmonte ata
21 që t'i nxirrnin këto dokumente përpara, ne mund t'i japim
22 atyre dokumentacionin tonë për t'i treguar se cilat dokumente
23 kërkojmë.

24 Ne besojmë që nuk është një numër shumë i madh
25 dokumentesh që duhet t'i nxjerrin ata deri me 30 shtator. Po

1 t'i kishim bërë gjithë kërkimet tona, atyre 5000 dokumenteve
2 që nuk ishin -- për shembull po të ishin 5000 që s'i kanë
3 kërkuar asnjë nga Mbrojtjet e tjera, atëherë po do të ishte e
4 drejtë që të jepej një afat më i vonshëm. Por ne i kemi
5 kërkuar materialet tona, pjesën më të madhe e kemi kërkuar
6 përpara, me sa duket ZPS-ja do t'i nxjerri dokumentet e
7 kërkuara të paktën deri më 30 shtator. Kështu e kuptojmë.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. O'Reilly.

9 Në lidhje me këto 263 dokumente, në qoftë se e bëjmë
10 aritmetikën pak, duhet të jetë një çështje ditësh apo jo, tre
11 javë, jo më shumë se aq do t'ju duhen.

12 Z. Robert.

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

14 Ne kemi paraqitur mendimet tona në hollësi dhe në lidhje
15 me rregullën 102(3), kështu që nuk do t'i përsëris ato tani,
16 po marr parasysh edhe ato që kanë shpjeguar kolegët e mi.

17 Unë do t'i referohem Konferencës për Ecurinë e Çështjes
18 që u bë një muaj përpara dhe ne kërkuam që atë natë të na
19 jepnin çdo gjë atëherë dhe do të është ishte më e lehtë në
20 qoftë se do të na e kishin dhënë atëherë se sa të merremi me
21 kërkesat në vazhdim tani për dorëzim dokument.

22 Por, këtu jemi tani dhe gjendja është se sa dokumente do
23 të jenë të cilat do të jenë objekt i kundërshtimeve për
24 materialin e tyre apo i masa mbrojtëse.

25 Shqetësimi im është që njësoj si kryeministri britanik që

1 sapo u hoq, ai do të -- ata do të zvarrisin e do të zvarriten
2 derisa t'i heqin e kjo çështje do të vazhdojmë.

3 Dhe nuk po përpiqem të bëj shaka këtu, po e kam seriozit.
4 Ky është një informacion shumë i rëndësishme që na duhet. Kjo
5 listë dokumentesh dhe në lidhje me këto tabela që përmenden,
6 një ditë përpara -- është shumë interesante, se një ditë
7 përpara se të bëhej Konferenca për Ecurinë e Çështjes
8 Prokuroria na çoi një numër të madh tabelash ku detajohen
9 dokumente të ndryshme të cilat janë nxjerrë sipas rregullës
10 102(3).

11 Pra, na është dhënë një lloj informacioni që kemi kohë që
12 e kërkojmë. Kjo na ka ndihmuar.

13 Por, një informacion tjetër që na duhet është që ata e
14 kanë ndonjëherë na kanë dorëzuar të njëjtin dokument që na e
15 kanë dhënë edhe përpara në bazë të një rregulle tjetër. Sepse
16 shumë shpesh Prokuroria i ka parë dokumentet një herë në bazën
17 e rregullës 102(3), pastaj e kanë vënë re që këto dokumente
18 duheshin dorëzuar sipas 103, e kjo ka ndodhur shumë shpejt.
19 Pra që të dimë ne ku i kemi dokument, na duhet informacion i
20 mirë, të na jepet informacion nëse dokument janë dhënë më
21 përpara dhe në bazë të cilit rregull dhe kjo do të na
22 ndihmonte shumë.

23 Dhe ne e thamë që kjo ka qenë kaotike. Është gjithmonë
24 vështirësi e madhe për ne që të bëjmë përputhjen midis
25 dokumentit që është dorëzuar dhe ku bie ai në listë. Është në

1 interesin tonë ta dimë se çfarë na është dhënë, kur dokumentet
2 na jepen me numra ERN të ndryshme, kur mund të jenë të njëjta.
3 Pra është shumë e komplikuar.

4 Ne kemi marrë më duket 20 tabela nga rreth 40 paketa të
5 materialeve sipas rregullës 102(1)(b). Do të na duhen edhe të
6 tjera.

7 Për sa i përket kërkesave për masa mbrojtëse apo
8 kundërshtimeve për rëndësinë materiale të dokumenteve, mendoj
9 që Prokuroria i ka zgjidhur, thotë, 65 për qind të kërkesave.

10 Kjo lë nja 22,000 dokumente për të cilat ende nuk është
11 dhënë përgjigje. Atëherë sa dokumente të tjera do të jenë
12 objekt i kundërshtimeve të rëndësisë materiale? A do të jenë
13 50, a do të jenë 20? Atëherë në qoftë se janë kaq atëherë
14 pritja deri nga fundi i shtatorit është OK. Por do të jenë
15 këto dokumente 2000, 3000 apo 10,000 atëherë kjo është krejt
16 çështje tjetër. Aq më herët t'i marrësh aq më mirë.

17 Pra, ne supozojmë që mbasi Prokuroria t'i ketë
18 identifikuar disa dokumente dhe ajo do të kundërshtojë
19 rëndësinë materiale të tyre.

20 U dha -- indikimi në herën e kaluar ishte që ka pasur
21 dokumente të shumta që ne i kemi kërkuar dhe të cilat ishin të
22 ngjashme. Në qoftë se ata janë në gjendje t'i bëjmë këto, t'i
23 nxjerrin këto dokumente, pse të mos i nxjerrin tani. Dhe
24 referenca që i bëhet që mund të bëhen kundërshtime në të
25 ardhmen, në vijimësi, po kjo mund të dojë të thotë gjëra të

1 ndryshme për njerëz të ndryshëm. Në "vijimësi" mund të dojë të
2 thotë me 27, 28, 29 shtator ose mund të jepen javën e ardhme,
3 apo nuk e di në fund të gusht.

4 Pra, na duhet më shumë qartësi, në lidhje me numrin e
5 dokumenteve me llojin e dokumenteve dhe se kur është kjo e
6 ardhmja a afërt apo kur do të bëhet dorëzimi i tyre në
7 vijimësi dhe çfarë do të thotë kjo. Dhe ne duhet të ecim
8 përpara në lidhje me marrjen e këtyre dokumenteve përpara se
9 sa të përgatisim dosjen tonë paraprake.

10 Sepse me sa kuptoj unë qëllimi juaj, për caktimin e datës
11 30 shtator si afat, në teori është që këto t'i dokumente t'i
12 kishim ne në dorë përpara se sa të bëjmë dosjen paraprake. Në
13 qoftë se nuk do t'i kemi, atëherë, kjo nuk do të na ndihmojë.

14 Pra, unë po përpiqem të bëj propozime konkrete për të
15 ndihmuar Prokurorinë për t'ju ndihmuar ju, për të ndihmuar
16 edhe veten, në mënyrë që të përgatitemi sa më mirë dhe që
17 çështja të eci përpara.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Roberts.

19 Unë nuk jam kryetar i komitetit 1922, mirëpo kam autorizim që
20 të caktoj afatin në mënyrë që Prokuroria të bëjë çmos të
21 ndihmojë në këtë drejtim.

22 Tani do t'ja japim z. Ellis, përsëri fjalën në lidhje me
23 për afërsi dy pika që përmendi Mbrojtja e Selimit, që është
24 mundësia e dhënies së këtyre tabelave në vijimësi sa më shpejt
25 që është e mundur dhe numri i përgjithshëm i për afërt në

1 lidhje me këto kundërshtimet e mundshme të rëndësisë
2 materiale. Po thjesht na jepni në përqindje, për shembull 0,1
3 për qind apo 10 për qind apo 50 për qind të dokument të
4 mbetura për nxjerrje.

5 Përpara se t'ja jap fjalën Prokurorit, ja jap një herë
6 fjalën z. Ellis.

7 Urdhëroni z. Ellis.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, klienti im, z.
9 Krasniqi dhe të gjithë të akuzuarit e tjerë janë në paraburgim
10 ka 20 muaj dhe ne jemi ende në fazën paraprake, për shkak se
11 procesi i nxjerrjes po vazhdon.

12 Z. Krasniqi padyshim dëshiron që çështja t'i transmetohet
13 Trupit Gjykses për gjykim sa më shpjet që është e mundur.

14 Prandaj, kur e dëgjojmë Mbrojtjen - më falni -
15 Prokurorinë duke thënë se e kanë përshpejtuar procesin e
16 nxjerrjes në javët e fundit, padyshim që ne e mirëpresim një
17 hap të tillë. Mirëpo kjo nuk tregon se është shënuar një
18 përparim i madh deri tani.

19 Nuk dua që të bëj parashtrime të gjata. Në lidhje me këtë
20 ne përkrahim parashtrimet e Mbrojtjes së Selimit. Dhe
21 gjithashtu na shqetëson fakti që kundërshtimet në lidhje me
22 rëndësinë materiale të dokumenteve po bëhen në një fazë të
23 vonshme.

24 Nuk e dimë në qoftë se për këtë do të duhet një urdhër
25 apo do të mjaftojë që të jetë vetëm një udhëzim, mirëpo duhet

1 që palët dhe pjesëmarrësit të ecin përpara sa më shpejt që
2 është e mundur.

3 Për sa i përket listës së përditësuar të njoftimit të
4 rregullës 102(3), më duket që njoftimi i fundit është bërë në
5 korrik. Me siguri ka dokumente të tjera që janë tani në
6 posedim të Prokurorisë dhe për të cilat Prokuroria ka dijeni.
7 Pa dyshim që një listë e përditësuar është e domosdoshme dhe
8 kërkohet që për këtë të vendoset një afat, pra për dorëzimin e
9 një liste të përditësuar.

10 Dhe ne dëshirojmë që këto dokumente të gjitha të na jepen
11 përpara afatit që kemi për të dorëzimin e dosjes tonë
12 paraprake, në mënyrë që të gjithë të mund, të gjithë ekipet e
13 Mbrojtjes të mund t'i plotësojnë detyrimet e tyre në lidhje me
14 dosjen paraprake.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Ellis.

16 Do t'ja jap fjalën Prokurorit dhe kam edhe një pyetje për
17 Prokurorin. Kur realisht do të jeni në gjendje që ta dorëzoni
18 njoftimin e përditësuar të rregullës 102(3)? Nëse mund të na
19 jepni një datë të përafërt kur kjo do të jetë e mundshme, pa
20 shkaktuar vonesa në procesin e nxjerrës së materialeve.

21 Urdhëro, z. Prokuror.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

23 Do t'i përgjigjem pyetjes së fundit në parashtrimet tona
24 që në tetor do të mund ta bëjmë dorëzimin në fjalë.

25 Z. Ellis po thotë që këto dokumente ndoshta nuk do të

1 mund t'i marrin përpara afatit për dorëzimin e dosjes
2 paraprahe dhe kanë të drejtë. Mirëpo çdo gjë që ka të bëjë me
3 njoftimin e rregullës 102 duhet të jepet dhe nxirret dhe kjo
4 është pjesa më e madhe e dokumenteve. Ne do të përpiqemi që të
5 përmbushin afatin e datës 30 shtator dhe pjesa më e madhe e
6 material do t'ju vihet në dispozicion ekipeve të Mbrojtjes
7 përpara afatit të dorëzimit të dosjes paraprahe të tyre.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Kur thoni tetor për çfarë
9 date e keni fjalën 1, 15 apo 30 tetor?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Realisht do të na duhet të paktën
11 një javë pas afatit të shtatorit për materialet e rregullës
12 102(3) në mënyrë që të mund të nxjerrim listën e përditësuar.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Për sa i përket tabelave. Ne këto
15 tabela po ua dërgojmë ekipeve të Mbrojtjes dhe kjo bëhet vetëm
16 kur një kërkesë e Mbrojtjes është plotësuar në mënyrë --
17 Mbrojtja ka numra të ndryshme të këtyre tabelave.

18 Për shembull, Mbrojtja e Selimit ka një kërkesë të
19 rregullës 102(3) me mbi 42,000 materiale në të, që është më
20 shumë se gjysma e njoftimit të listës së parë sipas rregullës
21 102(3). Kjo tabelë ende nuk është gati sepse nuk është e
22 përfunduar.

23 Për sa i përket kundërshtimeve të materialitetit, në këtë
24 moment ZPS-ja nuk ka bërë kundërshtime në këtë çështje, në
25 lidhje me tabelë rëndësinë materiale të dokumenteve dhe është

1 përpjekur që ta zgjidhë këtë çështje me diskutime midis palëve
2 dhe është arritur sukses në këtë drejtim me disa ekipe të
3 Mbrojtjes, sepse disa prej tyre edhe i kanë tërhequr kërkesat
4 sipas rregullës 102(3) në lidhje me drejtim disa materiale.

5 Në qoftë se nuk ka ndonjë pyetje tjetër në lidhje me
6 parashtrimet tona, i nderuar Gjykatës, kaq kemi ne.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

8 Në lidhje me këto tabelat e kuptoj që nuk jepni ndonjë
9 datë, afat të synuar, mirëpo a ju kam kuptuar drejt se do të
10 përpigëni që t'i jepni ekipeve të Mbrojtjes këto tabela mes
11 datës 30 shtator -- mes datës së sotme dhe 30 shtatorit në
12 vijimësi.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Më keni kuptuar drejt i
14 nderuar Gjykatës. Prej tani deri me 30 shtator.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Urdhëroni, z. Roberts.

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] Sa është për shembull afër 1 për
17 qindëshit, 60,000 dokumente, apo 600 dokumente, 600
18 intervista. Unë këtë nuk e di.

19 Prandaj do të kërkoja nga kolegu im, që të na japi një
20 farë qartësimi në lidhje me këtë. Të paktën deri nga fundi i
21 javës, jo domosdoshmërisht gojarisht tani, pra informacion
22 lidhur me llojin e dokumenteve për të cilat po bëhet fjalë. E
23 dimë që është një detyrë mjaft e vështirë për të bërë
24 identifikimin e të gjitha këtyre dokumenteve, mirëpo do të na
25 duhet ky informacion në mënyrë që dhe ne t'i plotësojmë afatet

1 për paraqitjen e kërkesave tona për dokument.

2 Prandaj edhe po bëhem pak shtytës në këtë drejtim në
3 mënyrë që t'i plotësojmë të gjitha detyrimet.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Roberst.

5 Z. Prokuror, a jeni në gjendje për të na dhënë më shumë
6 hollësi në lidhje me këtë material, pra ta informoni ekipin --
7 ekipet e Mbrojtjes apo mua deri nga java e ardhshme, për
8 shembull?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Mënyra se si formulohet pyetja,
10 përgjigje ime do të ishte edhe po edhe jo.

11 Përgjigja është jo për shkak se nuk mund të parashikojmë
12 me një saktësi se për cilat materiale do të bëjmë kundërshtime
13 në lidhje me materialitetin. Edhe nuk ka ardhur afati i 30
14 shtatorit dhe prandaj është e vështirë që t'ju jap një
15 informacion të përafërt.

16 Për sa i përket asaj se çfarë mund t'i them Mbrojtjes në
17 këtë moment, është se për disa materiale kemi identifikuar
18 çështje potenciale që lidhen me materialitetin, por na duhet
19 informacion shtesë në lidhje me këto, sepse në atë mënyrë do
20 të dimë në qoftë se do të bëhen kundërshtim ose jo në lidhje
21 me materialitetin e tyre. Prandaj edhe Mbrojtja do të marrë
22 informacion nga ne shumë shpejt në lidhje me kundërshtimet e
23 materialitetit

24 Dhe në qoftë se ju i nderuar Gjykatës doni të caktoni një
25 farë afati në lidhje me këtë ne do t'i përmbani atij afati.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror
2 Tani do të kaloj te materialet e rregullës 107.

3 Vërej se ZPS-ja vazhdon në mënyrë aktive diskutimet me
4 dhënësin e informacion sipas rregullës 107, në mënyrë që
5 çështjet e pazgjidhur të zgjidhen sa më shpejt që të jetë e
6 mundur.

7 ZPS-ja ka bërë të ditur se për rreth 400 materiale duhet
8 ende autorizim. Pjesa më e madhe këtyre materiale ka të bëjë
9 me një dhënës të vetëm informacioni, i cili është në procesin
10 e përpunimit të grupit të fundit të materialeve.

11 ZPS-ja parashikon të bëjë kërkesën lidhur me materiale
12 për të cilat është marrë autorizim dhe për një material për të
13 cilin nuk është marrë autorizim.

14 ZPS-ja gjithashtu ka bërë të ditur se pret përfundimin e
15 diskutimeve me një shtet të vetëm në lidhje me një parashtrim
16 të ardhshëm. Ftoj ZPS-në të bëjë parashtrime lidhur me këtë
17 pikë, përkatësisht në lidhje me afatin kohor të kërkesave të
18 ardhme. Gjithashtu ftoj ZPS-në të deklarohej se nën cilën
19 rregull bien këto dokumente, veçanërisht në qoftë se ato janë
20 brenda rregullës 102(3) apo rregullës 103.

21 Mbrojtja e Selimit konkretisht kërkon që t'i dorëzohen, e
22 para, lista plotësuese e rregullës 102(3) deri me 31 gusht
23 2022, e cila duhet të përfshijë të gjitha dokumentet shtesë
24 sipas rregullës 102 të cilat paraprakisht nuk janë përfshirë
25 në listën e parë të rregullës 102(3) dhe çdo dokument tjetër

1 që duhej të ishte përfshirë në këtë listë ose që është marrë
2 nga ZPS-ja më pas, pra pas parashtrimit të listës së parë të
3 materialeve.

4 E dyta, Mbrojtja e Selimit kërkon një status të
5 përditësuar të dokumenteve sipas rregullës 107 që janë
6 përfshirë në listën e parë të rregullës 102(3).

7 Mbrojtja e Krasniqit kërkon urdhër për ZPS-në që të
8 përmbushë obligimin e nxjerrjes sipas rregullës 107 deri në 30
9 shtator 2022.

10 Ftoj ZPS-në që të bëjë parashtrimet gojore në lidhje me
11 këto pika.

12 Urdhëroni z. Prokuror.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Ne kemi bërë një kërkesë, siç e
14 kemi përmendur në parashtrimet tona, mbulon 28 materiale. Disa
15 janë sipas rregull 103, edhe disa sipas rregullës 102(3). E
16 pranojmë që versioni konfidencial i asaj kërkesë nuk është
17 ende gati. Është duke u përgatitur dhe do të parashtrohet në
18 të ardhmen e afërt.

19 Për sa i përket çështjes së materialeve të rregullës 107,
20 në njoftimin - të përfshira në njoftimin e rregullës 102(3),
21 ka disa materiale që janë të rregullës 107 që ne i kemi
22 përfshirë në listën e rregullës 102(3), për të cilat kemi
23 menduar se ekziston mundësia që do të merret autorizim.

24 Për sa i përket ndarjes së vijës, vijës ndarëse,
25 materialet e rregullës 107 të cilat mbeten në afatin e 30

1 shtatorit që kanë qenë të përfshira në njoftimin e rregullës
2 102(3) ato do të nxirren deri me 30 shtator, për atë sa merret
3 autorizimi mjaftueshmërisht më përpara.

4 Për sa i përket vendimeve të ardhme të autorizimit apo
5 refuzimit të autorizimit, do të bëhen edhe disa parashtrime
6 sipas rregullës 107.

7 Caktimi i një afati për nxjerrjen e materialeve sipas
8 rregullës 107 nuk mund të detyrojë dhënësin e informacionit në
9 fjalë që të angazhohet në mënyrë domethënëse për avancimin e
10 procesit.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Urdhëroni z. Kehoe.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Ne po mbahemi në errësirë në lidhje
13 me këto dokumente. Ka pasë disa çështje që lidhen me
14 materialet e rregullës 103. Janë rreth 28 materiale që i janë
15 nxjerrë Gjykatësit dhe të cilat në fakt janë materiale
16 shfajësuese.

17 Kur do të merren këto autorizime të materialeve sipas
18 rregullës 107? A i ka bërë kërkesat Prokurori? Çfarë është
19 duke ndodhur për këtë moment? A ka bërë ndonjë kërkesë përpara
20 Gjykatës në mënyrë që të përshpejtohet ky proces? Pra që të
21 mund dhënësit të informacionit t'ju kërkohet ta përshpejtojnë
22 procesin sepse këta persona po mbahen në paraburgimin ka gjatë
23 kohë.

24 Pra, është përsëri ky elementi i kohës që po përsëritet,
25 i vonesës. Dhe kjo nuk na ndihmon që ta çojmë përpara

1 çështjen. Nuk e ndihmon asnjë palë në këtë proces.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

3 Urdhëroni, z. Emmerson.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do t'i kërkoj znj. O'Reilly që të
5 paraqesë komentet e veta në lidhje me paraqesë substancën,
6 thelbin. Por, përgjithësisht do të them disa fjalë në lidhje
7 me problemet e nxjerrjes së materialeve dhe konkretisht me
8 vështirësitë e materialet të rregullës 107. Ne kemi përpara
9 afatin e dorëzimit të dosjeve paraprake dhe kemi ndërmend që
10 ky afat të mbetet i pandryshuar. Është pika e cila ndikon
11 zhvillimin e mëtejshëm të procedurave. Pra, nuk duam që të
12 kërkohet shtim, zgjatje e afatit sepse Prokuroria nuk i ka
13 përmbushur detyrimet e veta të nxjerrjes së materialeve.

14 Ajo që është një problem akut në lidhje me materialet e
15 rregullës 107, siç tha z. Kehoe, është padyshim se aty janë
16 përfshirë materiale të rregullës 103, por aty mund të jenë
17 përshirë edhe përzierje materialesh apo materiale të ndryshme
18 që mund të jenë të rëndësisë së konsiderueshme për Trupin
19 Gjykues që do të caktohet në këtë çështje. Materiale prej
20 burimeve të pavarura në lidhje me konfliktin, pra burime që
21 janë jashtë dy protagonistëve kryesorë.

22 Ne, kolektivisht kemi bërë një parashtrim në lidhje me
23 nevojën e identifikimit se cilat prova janë nga burime të
24 korruptuara dhe të dyshimta dhe që lidhen me Serbinë.

25 Pra, ky është qëndrimi i jonë për sa i preket palëve në

1 konflikte. Mirëpo këto materiale janë të rëndësishme meqë janë
2 nga palë që nuk kanë qenë drejtpërdrejtë të përfshime në
3 konflikt.

4 Pra, ajo si e kuptoj unë dhe si e kemi parashtruar me
5 shkrim, sasia e materialeve për të cilat ende nuk është marrë
6 autorizim dhe të cilat ende nuk janë lëshuar, është dikund
7 rreth 400 dokumente. Dhe ne krejt e kemi të qartë se çfarë
8 ndikimi ky lloj dokumentacioni mund të ketë. Dokumentacion që
9 është nga burime qeveritare apo ndërqeveritare dhe që mund t'i
10 japë një farë forme çështjes. Pra duhet të gjejmë një farë
11 zgjidhje dhe kjo ka të bëjë me të gjitha këto materialet e
12 nxjerra kohëve të fundit, por sidomos shihet më së miri me
13 materialin e rregullës 107. Tregohet qartë se materiale kyçe
14 nuk i janë nxjerrë Mbrojtjes.

15 Ndoshta kjo mund të zgjidhet duke përmendur edhe pasojat
16 që mund të ketë për dorëzimin e dosjes paraprake. Në qoftë se
17 dorëzohet dosja në fillim të tetorit, Mbrojtja do të jetë e
18 dëmtuar nga vetë fakti që Prokuroria nuk do të mundë t'i
19 përmbushë detyrimet e nxjerrjes. Dhe nuk mund të ndodhemi në
20 një situatë ku, për shembull, Mbrojtja duhet të bëjë kërkesë
21 për dorëzimin e një dosjeje paraprake të ndryshuar, nën dritën
22 e materialit që do t'i jepet me vonesë nga Prokuroria.

23 Kërkoj që këtë afat aktual ta ndryshoni në një afat për
24 dorëzimin e dosjes paraprake provizore apo diçka të tillë, pra
25 me një formulim të tillë.

1 Tani do t'ja jap fjalën znj. O'Reilly për të trajtuar
2 disa çështje të tjera që lidhem me materialet 107.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

4 Mendoj që Konferencë e ardhshme për Ecurinë e Çështjes
5 do të jetë momenti i duhur për trajtimin e kësaj pike sepse
6 mund të arrihet ndonjë përparim, gjërat të ecin përpara në dy
7 muajt e ardhshëm.

8 Mendoj që do të jetë kohë e mjaftueshme për të gjithë
9 palët.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ne nuk duam që atë afat që e kemi
11 ta ndryshojmë.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, absolutisht
13 pajtohem me ju.

14 Urdhëroni, znj. O'Reilly.

15 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Vetëm një pikë, i nderuar
16 Gjykatës, në lidhje me këto 400 dokumente.

17 Në konferencën e fundit na u tha që do të na jepen
18 qartësime të mëtejshme në lidhje me materialet e rregullës
19 107.

20 Kemi bërë një email dhe aty kemi kërkuar ndarjen e
21 materialeve sipas kategorive, fajësues, material shfajësues,
22 apo material tjetër. Në përgjigje të atij emaili nuk kemi
23 marrë informacion se ndër cilin rregull bien ato 400
24 dokumente.

25 Megjithatë, do të na ndihmonte sikur të kemi një farë

1 qartësimi apo udhëzimi se për çfarë lloj dokumentesh flasim,
2 për dokumente të rregulle 102(3) apo të rregullës 103. Për ne
3 është plotësisht e arsyeshme që ky informacion të na jepet, në
4 mënyrë që të përcaktojmë nëse ai dokument në fjalë është i
5 nxjerrshëm ose jo, apo nëse për të duhet autorizim ose jo i
6 dhënësit të informacionit.

7 Faleminderit znj. O'Reilly.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Urdhëroni z. Emerson.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Vetëm një fjali. Ka të bëjë me
10 lidhjen midis asaj që e tha znj. O'Reilly, ju, i nderuar
11 Gjykatës, pak përpara. Do të ishte thelbësore që kjo të dihet
12 deri në Konferencën e ardhme mbi Ecurinë e Çështjes si moment
13 i fundit, në qoftë se Prokuroria mendon që pjesa më e madhe e
14 këtyre materialeve është fajësues apo shfajësues në mënyrë që
15 kjo të mos ketë ndikim të madh në dosjen paraprahe.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emerson.

17 Do t'i kërkoj ZPS-së që ta trajtojë këtë pyetje në
18 përgjigjen e vet.

19 Tani fjalën do t'ja jap z. Robert.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit z. Gjykatës.

21 Shkurtimisht, kemi paraqitur parashtrimet tona në
22 paragrafin 164 dhe në kërkesat tona të mëhershme lidhur me
23 plotësimin e listës 102(3).

24 Kërkesa ka të bëjë me 107 dokument për të cilat është
25 marrë autorizim dhe për të cilat ZPS-ja ka kërkuar autorizim

1 dhe për të cilat ende nuk është marrë vendim. Dhe se kjo mund
2 të zgjidhet deri nga fundi -- deri në afatin e tetorit.

3 Prandaj, edhe mendoj se duhet të caktohet një farë afati
4 sepse kjo do ta ndihmojë ZPS-në në negociatat e tyre me
5 dhënësin e materialeve, se nëse nuk ka një afat dhënësi i
6 informacionit e merr më ngadalë punën dhe prandaj kjo nuk e
7 ndihmon as ZPS-në. Një urdhër ndoshta do t'i çojë gjërat
8 përpara në qoftë se jo atëherë do ta dimë që nuk i çon dhe do
9 të mund të ndërmarrim masa të tjera.

10 Ne duam ta plotësojmë dhe t'i përmbahemi afatit që kemi
11 për dorëzimin e dosjeve paraprake dhe atë afat nuk duam ta
12 ndryshojmë sa më herët që të kemi një informacion në lidhje me
13 këtë. Dhe e kam parasysh emailin e Prokurorit që ia ka dërguar
14 Mbrojtjes së Veselit në lidhje me 400 dokumente, por përsëri
15 sa më herët që të kemi një qartësi, aq më mirë për të gjitha
16 palët në lidhje me ecurinë e negociatave midis dhënësit të
17 informacionit dhe ZPS-së.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Roberts.

19 Z. Ellis.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne përkrahim të
21 gjitha parashtrimet e ekipeve të tjera Mbrojtëse.

22 Ne kemi ngritur këtë shqetësim që në parashtrimet me
23 shkrim të datës 13 nëntor 2020 kur Prokuroria na siguroi se
24 ata po kërkojnë në mënyrë aktive autorizim për dokumente të
25 rregullës 107.

1 Siç tha edhe kolegu im, caktimi i një afati ndoshta nuk
2 do të jetë detyrues për dhënësin e informacionit, afati si
3 afat. Mirëpo mund të paktën të na ndihmojë të gjithëve që të
4 përqendrohemi. Kemi datën e caktuar për dorëzimin e dosjeve
5 paraprahe. Na duhet një informacion.

6 Bëhet fjalë për 400 dokumente. Nuk dimë se sa faqe
7 dokumentesh janë mirëpo është shumë e lehtë të paramendohet se
8 bëhet fjalë për një volum të madh materialesh dhe caktimi i
9 një afati do të na ndihmojë të gjithëve.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Ellis.

11 Urdhëroni, z. Prokuror.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Për sa i përket parashtrimeve të
13 z. Selimi, Mbrojtjes së z. Veseli, më falni.

14 Dua të theksoj se parashtrimet e sotme me gojë ndryshojnë
15 nga ato me shkrim të paraqitura në paragrafin 20 të atij
16 parashtrimi, në lidhje me Konferencën e fundit mbi Gjendjen.
17 Mbrojtja ka njoftuar se e ka pranuar informacionin rreth 400
18 dokumenteve dhe se e ka ditur këtë.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se është
20 në interesin tuaj z. Prokuror të kundërshtoni ndryshimet e
21 afateve të Mbrojtjes, por vazhdoni.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Për sa i përket çështjes së
23 kategorizimit.

24 Kategorizimi i materialeve të rregullës 107 është një
25 kërkesë që është jashtë detyrimeve të ZPS-së. Mbrojtja nuk

1 është e autorizuar të dijë asgjë gjë rreth materialit të
2 rregullës 107 përpara se ato të autorizohen dhe kategorizimi i
3 informacionit të mbledhur në lidhje me to është një detyrë që
4 ZPS-ja mund ta plotësojë në këtë moment.

5 Burimet e materialit 107, për momentin, po përdorin për
6 të siguruar autorizimet nga ZPS-ja -- e të drejtës së ZPS-së.

7 Ka rreth 400 materiale të cilat janë nën diskutim
8 aktualisht. ZPS-ja ka nxjerrë 22,000 materiale unike, vetëm
9 gjatë të shtatë javëve të fundit dhe kjo është një sasi e
10 madhe materiale. Ajo që thotë Mbrojtja e Veselit është
11 spekulative sepse Mbrojtja nuk mund ta dijë se çfarë është në
12 ato dokumente.

13 Ajo që thoni, që keni sugjeruar ju, i nderuar Gjykatës,
14 është plotësisht e zbatueshme për ne.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit, z.
16 Prokuror.

17 Z. Kehoe, vazhdoni.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Atëherë, sa i takon rregullës 103,
19 rregulli -- materiali nën rregullin 103 është material
20 shfajësues.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, e mbajta
22 shënim këtë gjë z. Kehoe.

23 Z. Emmerson.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Zakonisht nuk ngrihem në këmbë
25 për të korrigjuar z. Halling, pavarësisht faktit që ai ka

1 zakonin e të qenit patetik, siç bëri atë që bëri para pak
2 minutash.

3 Megjithatë, dua ta theksoj edhe një herë që është shumë e
4 rëndësishme për neve që të mos e humbasim datën sa i takon
5 dorëzimit të dosjes paraprake. Asnjë nuk ka ndryshuar lidhur
6 me këtë. Këtë e thashë edhe para pak minutash.

7 Edhe thjesht, me respekt, do të doja t'i kërkoja z.
8 Halling të tërhiqej nga pjesa e parashtrimeve të tilla që ai
9 bëri.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emerson.

11 Nuk e di në qoftë se ekipet e tjera kanë ndonjë gjë për
12 të shtuar lidhur me këtë element. Ekipet e Mbrojtjes nuk është
13 se kanë ndonjë gjë për të shtuar.

14 E shikoj që ka vajtur ora 15.00, kështu që do të bëjmë
15 një pushim për përkthyesit. Atëherë kemi 20 minuta pushim, do
16 të mblidhemi përsëri në orën 15.20.

17 Seanca ndërpritet këtu.

18 --- Pauza fillon në orën 15.00

19 --- Seanca rifillon në orën 15.20

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Le të kalojmë tani tek
21 elementi tjetër në rendin e ditës që janë hetimet e Mbrojtjes
22 dhe hapat pasues.

23 Do t'u jap fjalën palëve veçmas për secilën prej
24 kategorive të cilat kanë të bëjnë me hetimet e Mbrojtjes. Së
25 pari, për ecurinë e hetimeve të Mbrojtjes; së dyti, të

1 shprehen me mundësinë e mundshme për mundësi hetimore unike;
2 së treti, të shprehen për ndonjë njoftim për alibi ose arsye
3 të përjashtimit të përgjegjësisë; së katërti, për pikat
4 juridike dhe faktike me të cilat palët pajtohen; së pesti, për
5 kundërshtimet e provueshmërisë së materialit provues të
6 nxjerrë; dhe së fundi, në qoftë se dhe kur palët do të kenë
7 mundësi që të identifikojnë një listë në çështjeve që janë
8 objekt i mosmarrëveshjes dhe një listë çështjesh që nuk janë
9 objekt i mosmarrëveshje.

10 I ftoj palët që të jenë sa më konciz për secilin prej
11 këtyre elementeve.

12 Le të fillojmë me gjendjen e hetimeve të Mbrojtjes.

13 Në parashtrimet me shkrim Mbrojtja e Thaçit tha se hetime
14 e veta janë në vijimësi, por pengohen nga disa faktorë që
15 shkojnë përtej kontrollit të Mbrojtjes dhe veçanërisht
16 protokollit të dëshmitarëve.

17 Mbrojtja e Veselit thotë që hetimet e saj janë në vijim e
18 sipër dhe që pret që hetimet e saj do të vijojnë përtej hapjes
19 së çështjes nga ZPS-ja.

20 Në pajtim me pozicionin e Mbrojtjes së Selimit, sipas
21 kësaj Mbrojtja hetimet e saja janë penguar nga protokollit i
22 dëshmitarëve dhe redaktimet e shumta të cilat ulin shumë
23 kapacitetin e Mbrojtjes për t'u takuar me takimet e ZPS-së.

24 Për të zbutur ndikimin e hetimeve të Mbrojtjes, Mbrojtja
25 e Selimit thotë se ka nevojë për qartësime lidhur me

1 deklaratat që lidhen me cilat redaktime në aktakuzë dhe në
2 dosje paraprake dhe se cilat prej këtyre redaktimeve do të
3 hiqen.

4 Mbrotjtja e Krasniqit synon që të kryejë hetime të tjera,
5 misione të tjera hetime, përpara dorëzimit të dosja paraprake.
6 Ajo tregon se ka dërguar 11 kërkesa për ndihmë në drejtim të
7 shteteve. Pesë ja u ka dërguar organizatave ndërkombëtare, dy
8 të tjera, subjekteve të tjera. Ajo parashikon gjithashtu që të
9 dorëzojë një kërkesë përpara Gjykatësit të Procedurës
10 Paraprake për ndihmë për bashkëpunim me organizata
11 ndërkombëtare, të parashikuar në rregullin 108(2) të
12 Rregullores.

13 I ftoj palët që të marrin fjalën, të shprehen lidhur me
14 ecurinë e çështjes, duke filluar me z. Kehoe.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, juve bëtë një
16 përmbledhje të saktë të disa prej pikave të cilat ne i kemi
17 parashtruar në dokument. Në redaktime të shumta të cilat janë
18 të pranishme, janë redaktime të cilat neve na pengojnë në
19 mënyrë të jashtëzakonshme. Për shembull, ne flasim për
20 paragrafin 141 të ankesës së re: ... e poredaktuar, "në vitin
21 1998" dhe pastaj redaktim përsëri, domethënë brenda dy
22 rreshtave ka disa redaktime. Domethënë, redaktohet vendi,
23 redaktohen njerëzit, gjithashtu edhe elementë operativë.

24 Jam i sigurt që ju e keni parë dokumentin e dëshmitarëve
25 edhe e shikoni besoj -- e keni parë edhe vetë me sytë tuaj që

1 faqe të tëra të deklaratave të dëshmitarëve janë të gjitha
2 bosh sepse janë me redaktime.

3 A e pengon kjo hetimin tonë? Pa diskutim. Kjo e lidhur me
4 nxjerrjen e vonuar të dokumenteve të cilat janë pjesë e
5 fushëveprimit të materialit sipas rregullës 102(3) dhe
6 gjithashtu dhe dokumente që priten nga OSBE-ja dhe nga Kombet
7 e Bashkuara dhe ato -- këto janë institucione të cilat neve na
8 kanë thënë që duhet të shikojnë arkivat e tyre për këto
9 dokumentet e tyre, kjo është një procedurë që nuk e ka bërë
10 ZPS-ja por që e kemi bërë ne.

11 Ne për muaj të tërë jemi përpjekur që të hymë në arkivat
12 e institucioneve të tjera, në mënyrë të tillë që çështja të
13 ecë përpara. Por, ka dëshmitarë në OSBE që me të cilët ne kemi
14 folur që dëshirojnë që të shoshin dokumentet në OSBE. Dhe mbi
15 bazën e kësaj, ne nuk kemi pasur mundësi që ta bëjmë këtë gjë
16 dhe kjo pa diskutim ka pasur ndikim mbi punën tonë,
17 veçanërisht në punën e znj. Menagon që është marrë me këtë
18 çështje në mënyrë të vazhdueshëm.

19 Ne kemi 91 dëshmitarë anonimë, nga 326 tërësisht. Disa
20 prej tyre do të japin dëshmi *viva voce* që është mbresëlënëse,
21 por nga numri i përgjithshëm i 326 dëshmitarëve, 91 janë
22 dëshmitarët që nuk janë nxjerrë dhe jemi 68 ditë përpara
23 gjykimit. Kjo është një sipërmarrje e jashtëzakonshme,
24 sipërmarrje të cilën neve po e përmbushim pavarësisht
25 kufizimeve të jashtëzakonshme që kemi përpara.

1 Përveç kësaj, protokolli i dëshmitarëve na ka lidhur
2 duart në mënyrë virtuale në disa mënyre. Ne kemi intervista të
3 planifikuara për një pjesë të mirë të qershorit dhe fillimit
4 të korrikut. Pas nxjerrjes së vendimit tuaj, i nderuar
5 Gjykatës, më 24 qershor, pra unë nuk kam -- nuk më duhet që të
6 vijoj që të veprojmë në kundërshtim me urdhrin tuaj, i nderuar
7 Gjykatës, kështu që më është dashur që të anulohet të gjitha
8 intervistat e planifikuara. Dhe nuk po flas për njerëzit të
9 cilët po japin dorëheqjen në Kosovë. Nuk po flasim për 91
10 dëshmitarë të mbrojtur, por po flas për individë të
11 Departamentit të Shtetit që jetojnë në Virxhinia dhe për të
12 cilët unë kam folur për muaj të tërë, që meqenëse ra fjala,
13 ata janë pjesë e dëshmitarëve të ZPS-së, megjithëse ZPS-ja nuk
14 e ka përmendur asnjëherë. Dhe mbështetur në vendimin që keni
15 dhënë juve, kam ndaluar së diskutuari këtë diskutim fare. Dhe
16 m'u desh që të përfshija edhe ZPS-në mbështetur në vendimin
17 tuaj.

18 Flasim për një diplomat që jeton në Shtetet e Bashkuara
19 dhe që është pjesë e Departamentit të Shtetit në Shtetet e
20 Bashkuara që po merr pjesë. Pavarësisht kësaj, protokolli
21 kërkon që ZPS-ja të na japë njoftim dhe intervistimi duhet të
22 jetë i filmuar, i regjistruar ndërkohë që ne nuk dimë asgjë.

23 Kështu që po a lëmë mënjanë kontekstin, mund ta mendoni
24 se sa e vështirë është pjesa e planifikimit të intervistave me
25 ndërkombëtarët në kalendar. Kemi shumë probleme të kësaj

1 natyre dhe nuk i kam kontaktuar në fakt këta dëshmitarë pas
2 datës 24 qershor, veçse kam marrë në telefon dhe ju kam thënë
3 që nuk mund të vazhdojmë përtej kësaj date. Ata nuk e kuptojnë
4 përse. Unë nuk jua kam dhënë këtë informacion, nuk u kam thënë
5 ndonjë gjë tjetër shtesë. Mendoj që Departamenti i Shtetit
6 mund të ketë dhënë ndonjë informacion më tepër.

7 Megjithatë, këto janë vështirësi të shumta, këto janë
8 vështirësi të cilat i kemi edhe sot e kësaj dite me dëshmitarë
9 dhe që nuk bëjmë dot asnjë lloj progresi më parë.

10 [REDAKTUAR].

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 Pra, ne do të vazhdojmë me hetimin sepse duam që procesi

16 të vazhdojë më tej. Në pajtim me atë çfarë tha miku im z.

17 Emmerson ne jemi të vendosur që të respektojmë datën e

18 dorëzimit të dosjes paraprake, megjithatë, më duhet të sjell

19 në vëmendjen tuaj që ka shumë probleme të mëdha të cilat kanë

20 të bëjnë me protokollin e dëshmitarëve sipas asaj çfarë

21 zbatohet për dëshmitarët ndërkombëtarë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Z. Emmerson.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do t'i kërkoj z. Strong që të

25 merret me këtë element. Megjithatë, qëndrimi i Mbrojtjes së z.

1 Veseli është që procesi pasues i marrëveshjeve që bëhen në
2 pika ose etapa të ndryshme të identifikuara, do të duhet që të
3 realizohet në mënyrë që Mbrojtja të informohet në vazhdimësi,
4 lidhur me detyrimet për nxjerrjen e materialeve që ka ZPS-ja.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe e keni mikrofonin
6 të ndezur.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dy elementë të tjerë të
9 rëndësishëm. Së pari, sa i takon protokollove të dëshmitarëve.
10 Të gjitha ekipet e Mbrojtjes janë palë e një apelimi kundër
11 kësaj dhe jam dakord me atë çfarë tha z. Kehoe që kemi disa
12 pengesa të tjera shtesë sa i takon shpejtësisë së hetimeve.

13 Por pavarësisht kësaj, ne po bëjmë përparim të
14 konsiderueshëm dhe shpresojmë, pavarësisht vështirësive të
15 shumta që kemi, që të kemi mundësi që të dorëzojmë dosjen
16 paraprake në datën e përcaktuar, duke mbajtur parasysh
17 kërkesat ligjore për dorëzimin e dosjes paraprake.

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

- 1 [REDAKTUAR]
- 2 [REDAKTUAR]
- 3 [REDAKTUAR]
- 4 [REDAKTUAR]
- 5 [REDAKTUAR]
- 6 [REDAKTUAR]
- 7 [REDAKTUAR]
- 8 [REDAKTUAR]
- 9 [REDAKTUAR]
- 10 [REDAKTUAR]
- 11 [REDAKTUAR]
- 12 [REDAKTUAR]
- 13 [REDAKTUAR]
- 14 [REDAKTUAR]
- 15 [REDAKTUAR]
- 16 [REDAKTUAR]
- 17 [REDAKTUAR]
- 18 [REDAKTUAR]
- 19 [REDAKTUAR]
- 20 [REDAKTUAR]
- 21 [REDAKTUAR]
- 22 [REDAKTUAR]
- 23 [REDAKTUAR]
- 24 [REDAKTUAR]
- 25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Shumë faleminderit.

3 Z. Strong, ju lutem.

4 Z. STRONG: [Përkthim] Do them -- do flas shumë shkurt.

5 Thjesht dua të them që hetimet e Mbrojtjes janë në vijim e
6 sipër. Diçka që doja të sillja në vëmendjen tuaj është si më
7 poshtë. Pavarësisht vështirëve që kemi hasur, objektivi ynë që
8 të ecin sa më shpejt të jetë e mundur. Ne duam që çështja të
9 dërgohet përpara Trupit Gjykses sa më shpejt që të jetë e
10 mundur dhe mundohemi që të mos kemi vonesa lidhur me hetimit.

11 Sa i takon detyrës, bëhet fjalë për 326 dëshmitarë, do të
12 duhet që të vlerësohen, të shqyrtohen 17,000 prova materiale,
13 një ngarkesë e jashtëzakonshme kohore dhe për këtë arsye, ne i
14 kemi kërkuar Prokurorisë që të na japë një lloj indikacioni,
15 një lloj informacioni të përgjithshëm se si do ta organizojnë
16 çështjen e tyre në mënyrë të tillë që të organizojmë burimet
17 që kemi në mënyrë efektive.

18 E di që do të flasim lidhur me këtë çështje sa i takon
19 pjesës së racionalizimit që është e parashikuar për më poshtë
20 në rendin e ditës por thjesht doja ta sillja në vëmendjen e
21 ZPS-së në mënyrë që të kishte një çast për të menduar për të
22 dhënë përgjigje.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young
24 tani.

25 Z. YOUNG: [Përkthim] Do t'ja jap z. Roberts sa i takon

1 procesit të hetimeve.

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do t'i kthehem kësaj pas
15 elementit për harmonizimin e procedurës dhe do t'i jap fjalën
16 Administratores.

17 Z. YOUNG: [Përkthim] Faleminderit.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young.

19 Z. Roberts, fjala për juve.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk dua të përsëris atë çfarë u
21 tha në detaje si nga z. Kehoe dhe nga z. Emmerson, por pa
22 diskutim që jam plotësisht dakord me ta lidhur me ndikimin e
23 vendimit të fundit që ka të bëjë me protokollin e kontaktit
24 dhe vendimeve të përgjithshme për masat mbrojtëse.

25 Atëherë përpara se sa të çohet Administratorja [sipas

1 përkthimit] dhe të thotë që ne do të kërkojmë rishqyrtim të
2 këtyre vendime thjesht do të thoja që nuk do ta kërkojmë këtë
3 gjë tani. Por, duhet të dimë diçka lidhur me pasojat, pasojat
4 e këtyre vendimeve bashkërisht cenojnë shumë aftësinë tonë për
5 të hetuar.

6 Ne mundohemi që të identifikojmë mënyra që t'i zgjidhim
7 këto probleme, por kjo nuk është një punë e thjeshtë. Të
8 kuptosh -- të mundohesh të kuptosh informacionin që është
9 redaktuar dhe të mundohesh të kuptosh se si mund t'i caktosh
10 burimet mbi bazën e pretendime të cilat na janë fshehur nga
11 redaktuar, është e vështirë për ne. Dhe për këtë arsye në
12 parashtrimet tona ne kemi ardhur me disa ide dhe shpresojmë që
13 këto ide të na ndihmojnë ne, pra, ekipet e Mbrojtjes.

14 Së pari, sa i takon protokolleve të dëshmitarëve, ne kemi
15 shumë dëshmitarë dhe për të folur me ta duhet që të kalojmë
16 nga Prokuroria, 326 dëshmitarë. Kështu që si rezultat, e para
17 duhet të jetë që ZPS-ja duhet t'ju thotë dëshmitarëve që janë
18 dëshmitarë dhe ata të mos surprizohen në qoftë se ekipet e
19 Mbrojtjes vendosin që të diskutojnë me ta. Ndërkohë që kjo
20 mund të shkurtojë vonesa që mund të shkaktohen në të ardhmen.
21 Ky është një hap shumë i thjeshtë.

22 Kuptimi im i 326 dëshmitarëve është që një pjesë e mirë e
23 tyre nuk do të jenë në dijeni të statusit të tyre. Kjo do të
24 ndihmonte ata dhe do të ndihmonte edhe ZPS-në për të
25 racionalizuar çështjen e tyre, në qoftë se veprojnë tani.

1 Me sa kuptoj unë, shumë prej këtyre dëshmitarëve nuk kanë
2 qenë në dijeni të faktit që kishin statusin e dëshmitarëve
3 deri në momentin kur është kërkuar -- kur janë kërkuar masa
4 mbrojtëse për ta. Dhe mund të ndodhë që ata të vihen në dijeni
5 për statusin e tyre në momentin kur të merren në telefon prej
6 nesh. Kështu që sa më shpejt të vendosë dhe të komunikojë ZPS-
7 ja lidhur me statusin e dëshmitarëve dhe çfarë pozicioni kanë
8 ata për procesin gjyqësor mendoj që kjo do t'çi shërbejë
9 procesit gjyqësor në përgjithësi.

10 Së dyti, sa i takon redaktimeve, redaktimeve në aktakuzë,
11 në dosjet paraprake, i nderuar Gjykatës, besoj se e keni parë
12 në parashtrimet tona në paragrafët 23 dhe 24, kur kemi dhënë
13 një rast specifik me një pretendim ku informacioni është i
14 gjithi i redaktuar. Pra, bëhet fjalë për një pretendim që
15 drejtohet konkretisht për klientin tim. Unë nuk mund ta
16 diskutoj këtë pretendim sepse nuk e kam idenë fare se mbi
17 ç'bazë është ngritur një pretendim i tillë. Ky është vetëm një
18 prej shumë shembujve të tillë.

19 Pasoja është që unë nuk hetoj dot. Pra, ekipi im nuk mund
20 të bëjë dot asnjë lloj hetimi lidhur me këtë pretendim dhe nuk
21 e di se kur një redaktim i tillë do të hiqet. Për shembull, në
22 lidhje me dëshmitarët -- me 91 dëshmitarët që përmendi z.
23 Kehoe ne nuk e dimë se identiteti i këtyre dëshmitarëve do të
24 hiqet 30 ditë përpara procesit gjyqësor apo ndonjë ditë
25 tjetër. Dhe disa, për shembull, dëshmitarë mund të japin

1 dëshmi në muajin e parë të gjykimit, disa të tjerë pas gjashtë
2 muajsh. Pra i gjithë informacioni i redaktuar do të hiqet në
3 të njëjtën kohë apo në mënyrë graduale?

4 Po ju kërkoj, i nderuar Gjykatës, që me ndihmën tuaj të
5 kërkohet dhe të marrim një informacion se kur do të hiqen këto
6 redakte në aktgjykim dhe gjithashtu edhe për sa i takon
7 dosjes paraprake. Ne jemi në dijeni të vendimit për
8 konfirmimin e aktakuzës dhe për mangësi të aktakuzës të cilat
9 janë të gjitha të mbështetura në redaktimin e aktakuzës dhe
10 këto të gjitha mbështeten tek vendimet tuaja për informacionin
11 edhe masat mbrojtëse. Dhe ky është informacion të cilin e keni
12 vetëm ju dhe Prokuroria.

13 Kështu që do të na ndihmonte shumë në qoftë se mund të na
14 jepni informacion për secilën prej këtyre redakteve,
15 domethënë konkretisht kur secili prej këtyre redakteve do të
16 hiqen. Në qoftë se, për shembull në paragrafin 41 dh 42 të
17 aktakuzës dhe kemi redakte aty, domethënë redaktimi do të
18 hiqet, ndoshta 30 ditë para gjykimit apo jo. ZPS-ja duhet të
19 na e thotë këtë gjë, duhet të ketë mundësi që të na e japë
20 këtë informacion sepse ky nuk është informacion konfidencial.
21 Dhe ne duhet të planifikojmë, për shembull, nëse mund të
22 mbështetemi në këtë informacion apo jo dhe duhet të
23 mbështetemi në kohën kur do të hiqen redakte të tjera.

24 Pra, nuk është diçka që do të cenonte masat mbrojtëse,
25 por do të ishte diçka që do të na ndihmonte shumë për sa i

1 takon hetimeve.

2 Sa i takon protokollit të dëshmitarëve dhe vendimeve për
3 kontaktin, ne shpresojmë që të kemi mundësi që të ecim përpara
4 për të ditur se çfarë hetimesh do të kenë përparësinë kryesore
5 dhe për të planifikua për pjesën e hetimeve.

6 Nuk e di në qoftë se doni që të trajtoj çështjen e
7 hetimeve unike hetimore apo jo, megjithatë janë çështje që të
8 gjitha janë parashtruar në parashtrimet tona.

9 Dua që të cek gjithashtu çështjen e 102(3). Dua të ndaj
10 pak nxjerrjen dhe hetimet. Por, nga ana tjetër nxjerrja e
11 materialeve dhe hetimet janë të lidhura me njëra-tjetrën. Nuk
12 është se materialet dhe nxjerrja e tyre është tërësisht e
13 palidhur me hetimet.

14 Hetimet tona mbështeten kryesisht në informacionet që na
15 jep Prokuroria ose mbështetur në rregullën 103 ose sipas
16 rregullës 102(3). Në qoftë se dëshirojmë që të flasim me
17 dëshmitarë të caktuar mund të ekzistojë mundësia që ZPS-ja të
18 ketë folur me ta. Por, ndoshta nuk mendoj që këta janë
19 dëshmitarët që do të thërrasin në sallën e gjyqit. Kështu që
20 në qoftë se ne dëshirojmë që të intervistojmë të njëjtin
21 person do të na ndihmonte shumë që të kishim deklaratat e
22 dhëna nga dëshmitari, zbardhjen e deklaratave të bëra nga prej
23 tij.

24 Pra, ajo çfarë po mundohem të them është që hetimet tona
25 varen nga ritmi i nxjerrjeve të materialit sipas rregullës

1 102(3). Pra, në qoftë se nëse do të përshpejtohen afatet kjo
2 do të na ndihmonte në kohën e duhur në mënyrë të tillë që të
3 shkojmë të flasim me dëshmitarët, dëshmia e të cilëve nxirret.

4 Pra, ka faktorë që shkojnë paralelisht me njëri-tjetrin
5 të cilët kanë efekt domino. Kështu që duhet të them edhe një
6 herë tjetër që hetimet e Mbrojtjes nuk janë të ndara nga
7 detyrimet e nxjerrës së materialeve që duhet të përmbushen nga
8 ZPS-ja.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Roberts.
10 Nuk e di, z. Ellis apo znj. Alagendra.

11 Z. Ellis.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Jemi në të njëjtin pozicion siç edhe
13 kolegët që folën më përpara dhe mbështes të gjitha pikat të
14 cilat u përmendën nga kolegët e mi.

15 Më lejoni të them që sa i takon hetimeve tona janë
16 vijimësi e sipër. Duke e pasur parasysh madhësinë e çështjes
17 edhe vonesat në nxjerrjen e materialeve, hetimet do të
18 vazhdojnë derisa të fillojë data e gjykimit por, mbase edhe
19 përtej saj. Pavarësisht kësaj ne po planifikojmë lidhur me atë
20 çfarë na duhet për të qenë në gjendje që të dorëzojmë dosjen
21 paraprake deri më datën 21 tetor.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Z. Prokuror ose znj. Prokurore doni të përgjigjeni?

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

25 Pak pika.

1 Sa i takon ndërveprimeve me organizatat ndërkombëtare ose
2 dëshmitarëve ndërkombëtarë dua të siguroj Mbrojtjen e Thaçit
3 që ndryshe nga parashtrimet që duam këtu ne i kemi parasysh të
4 gjitha problemet që shtrohen lidhur me këtë element. Ne kemi i
5 kemi hequr të gjitha pengesat që ekzistojnë për të kontaktuar
6 me organizatat ndërkombëtare apo me dëshmitarë ndërkombëtarë.

7 Lidhur me protokollin e dëshmitarëve. Ky është një
8 garanci procedurale shtesë. Megjithatë ajo thjesht rregullon
9 kontaktin me një kategori të ngushtë personash apo individësh
10 të cilët në fillim *prima facie* kanë synimin e tyre për të
11 bashkëpunuar me neve apo të cilët do të bashkëpunojnë në
12 vijimësi të gjykimit.

13 Ka pasur një kërkesë që është parashtruar në fillim të
14 dhjetorit 2021. Dhe sa i takon planifikimit dhe përgatitjes ky
15 nuk është një zhvillim i ri i parishikuar.

16 Ndërkohë, ka një qartësim që dua të bëj, rrjedhur nga ajo
17 çfarë u përmend nga parashtrimet e z. Thaçi. Ndërkohë në
18 paragrafin 9 të parashtrimeve, thuhet që Mbrojtja nuk mund të
19 propozojë data intervistimi për ZPS-në sa i takon të folurit
20 të parë me dëshmitarët përkatës. Dhe kjo reflekton një
21 keqkuptim thelbësor për protokollin.

22 Pra, mbështetur në parashtrimet me gojë të z. Kehoe,
23 ndoshta parashtrimi nuk ka pasur synimin që të formulohej
24 ashtu siç është formuluar, por për të qenë i qartë, Mbrojtja
25 mund të kontaktojë dëshmitarët për të cilët ZPS-ja ka njoftuar

1 synimin e saj për t'u mbështetur gjatë gjykimit.

2 Sa i takon Mbrojtjes së Selimit e kuptojmë që ata nuk
3 kërkojnë rikonsiderim apo rishqyrtim të redaktimeve të
4 autorizuara, por, thjesht kërkojnë që redaktimet të lidhen për
5 materialet përkatëse dhe informacionin që heqin këto
6 redakte. Dhe ndërkohë Mbrojtja ka dhënë paragrafë konkretë
7 në parashtimet me shkrim dhe një kërkesë e tillë duhet që të
8 rrëzohet.

9 Së fundi, Prokuroria vëren për procesverbal që nuk ka
10 ndërhyrë në asnjë mënyrë me privilegjet ndërmjet klientëve dhe
11 Mbrojtjeve.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Kjo nuk ishte e pritshme? Sigurisht
13 që nuk ishte e pritshme. Kjo çështje ka në listë që në nëntor
14 të vitit 2000 kur janë burgosur, kur janë ndaluar --
15 paraburgosur këta të akuzuar. A ka pasur ndonjë ankesë që
16 është frikësuar dikush, është kërcënuar dikush, sigurisht ne
17 nuk kemi marrë ndonjë ankesë të tillë. Nuk na ka thënë askush
18 neve si Mbrojtje që ndonjë dëshmitar ka qenë i frikësuar apo
19 nuk ka dashur të flasë me Mbrojtjen.

20 Asnjë Gjykatë tjetër as Tribunali i Hagës, as ICTR-ja as
21 tribunalet e tjera nuk kanë pasur procedura të tilla. As
22 redaktimet aty në ato gjykata nuk kanë qenë kaq ekstensive sa
23 janë këtu.

24 Ne po merremi me -- ne na kanë vënë pranga në
25 marrëdhëniet tona me dëshmitarët. Prokuroria ka të drejtën të

1 flasë me këta njerëz, ka të drejtën të diskutojë me këta
2 njerëz. Por pyetja është si të merrmi ne me një dëshmitar i
3 cili është në listën e Prokurorisë dhe që do të jetë edhe
4 dëshmitar për Mbrojtjen. Dhe Prokuroria nuk ka ndërmend t'i
5 thërrasë fare.

6 Ka diplomatë për shembull nga Shtetet e Bashkuara të
7 cilët nuk futen në këtë kategori. Edhe në ato raste ne duhet
8 të plotësojmë kushtet e këtij protokolli dhe t'i ftojme ata
9 dhe të ftojme Prokurorinë në diskutimet tona me atë
10 dëshmitarë. Përveç faktorit kohë janë edhe gjithë këto presona
11 të tjerë që do të vijnë në diskutimet tona me këta dëshmitarë
12 nga Zyra Administrative, nga Prokuroria.

13 Kjo do të na ndikojë shumë dhe do ta pengojë Procesin
14 tonë. Këta janë dëshmitarët e tyre, këta janë dëshmitarët që
15 kanë vënë ata në listën e tyre. Nuk po flas për dëshmitarë të
16 mbrojtur, nuk po flas për dëshmitarë që janë në Kosovë. Po
17 flasim për dëshmitarë për shembull, ndërkombëtarë, gra dhe
18 burra të njohur, të shquar në të gjithë botën që kanë mbajtur
19 pozita të larta.

20 Një oficer ushtarak i lartë në Mbretërinë e Bashkuar, në
21 Britani nuk frikësohet nga këto pretendime që thotë
22 Prokuroria.

23 Pra, të thuash që këto vështirësi, këto redaktime, këto
24 vonesa, përmes protokollit të dëshmitarëve nuk e pengojnë
25 Mbrojtjen? Me shumë respekt, i nderuar Gjykatës, por kjo duhet

1 rimenduar se si do të ndikojë kjo në proceset tona në
2 vijimësi.

3 Megjithatë, i nderuar Gjykatës, pavarësisht nga kjo ne
4 jemi të përkushtuar që të ecin përpara ta dorëzojmë dosjen
5 tonë paraprake në kohë dhe Gjykata dhe kushdo tjetër që na
6 dëgjon duhet të kuptojë vështirësitë që na janë vënë ne
7 përpara për çfarëdo arsye që Gjykata e mendoi të arsyeshme t'i
8 vendosë. Dhe kjo ndikon edhe tek klientët tanë.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Kehoe.

10 Nuk shoh ndonjë tjetër nga Mbrojtja që dëshiron të marrë
11 fjalën.

12 Znj. Prokurore keni diçka për të thënë?

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Z. Kehoe ka artin e dhënies së
14 përgjigjeve ndaj parashtrimeve që nuk janë bërë nga
15 Prokuroria. Nuk u tha asgjë - nuk tha asgjë lidhur me atë që
16 thashë unë.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Unë u përgjigja pikërisht për atë që
18 tha ajo.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani të vazhdojmë me
20 kërkesat për mundësi hetimore unike.

21 Në parashtrimet me shkrim, Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja
22 e Veselit konfirmuan se kanë ndërmjet të bëjnë kërkesa për
23 mundësi hetimore unike, megjithatë ata thanë se nuk do të jenë
24 në gjendje ta bëjnë këtë deri më 1 shtator 2022 që ishte
25 caktuar si afat.

1 Mbrojtja e Selimit dhe e Krasniqit thanë që nuk kanë
2 ndërmjet të -- nuk parashikojnë që të bëjnë kërkesë për
3 mundësi hetimore unike. Megjithatë Mbrojtja e Krasniqi nuk
4 duhet të përcaktohet një afat për rregullën, për kërkesat
5 sipas rregullës 99(1) [sipas përkthimit].

6 Ftoj Mbrojtjen që të thotë deri në shtator nëse do të
7 bëjë kërkesa të tilla në mënyrë që të mos vonohet transmetimi,
8 kalimi i dosjes tek Trupi Gjykses. Vë në dukje sidomos që në
9 qoftë se çështja gjyqësore do të kalojë tek Trupi Gjykses në
10 javët mbasi të dorëzohet dosja paraprake nga Mbrojtja, atëherë
11 duhet që këto masa të jenë kërkuar - më falni - këto mundësi
12 të jenë kërkuar deri atëherë.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk mund të them tani nëse do t'i
14 bëjmë këto kërkesat duke pasur parasysh vështirësitë që kemi.
15 E kemi shumë të vështirë që të marrim deponimet nga
16 dëshmitarët, për shkak të këtyre protokolleve që duhet të
17 zbatojmë. Jo vetëm që kemi këto protokolle, por kemi edhe këto
18 vështirësi, për shembull, të marrim informacione nga OSBE-ja
19 dhe nga Kombet e Bashkuara sepse duhet të kalojë përmes zyrës
20 administrative.

21 Dhe vendosja e këtyre kufizimeve kohore dhe këtyre
22 afateve, e këtyre afateve sidomos po të flasim për gushitin,
23 unë nuk mund të përkushtohen se do ta bëj brenda kësaj date.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në qoftë se nuk mund të
25 angazhoheni për atë datë, a do të përpiqni ta bëni sa më

1 shpejt që të jetë e mundur?

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Në qoftë se OSBE-ja na lejon që të
3 futemi te arkivat e tyre dhe dëshmitari me të cilin po merrem
4 është i gatshëm të bisedojë me ne, unë do të jem në gjendje që
5 të marr deponimin e tij brenda kohës së caktuar. Por, unë nuk
6 mund të futem tek dosja e tij dhe pozicioni i tij është që
7 kanë kaluar 23 vjet kështu që unë duhet të shikoj një herë se
8 çfarë ka ndodhur ose çfarë kanë dokumentet në lidhje me
9 ngjarjet në vitit 1998, 1999 që është kuadri kohor i
10 aktakuzës.

11 Pra, unë po përpiqem që ta bëj sa më shpejt që të jetë e
12 mundur, këtë dua të bëj sepse është në interesin tonë.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson apo z. Strong.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] Shumë shkurt. Me të gjitha pikat
15 e rendit të ditës që kanë të bëjnë me mundësitë hetimore unike
16 dhe me gjithë pikat e tjera dhe dua që të them që ne i
17 përmbahemi atyre parashtrimeve që kemi bërë me shkrim. Dhe dua
18 të them që ne nuk duam të vihem në një pozicion që ta vëmë
19 karrocën para kalit.

20 Për shembull, në çështjen e alibisë ne duhet të shohim se
21 çfarë dokumentesh do të na nxjerri Prokuroria përpara sesa të
22 bëjmë një kërkesë të tillë. Sigurisht ne e dimë që ekzistojnë
23 mundësi hetimore unike dhe duam që t'i ndjekim ato përpara
24 sesa të bëhet transferimi i çështjes te Trupi Gjykses, por do
25 t'ju njoftojmë juve dhe Prokurorinë në mundësinë më të parë

1 sepse nuk duam të vonohet procesi.

2 Por pozicioni jonë mbetet ai që kemi thënë me shkrim që
3 ne po përpiqemi t'i zhvillojmë çështjet deri aty ku mundemi në
4 këtë fazë dhe dosja paraprake do të zbulojë edhe pikat në të
5 cilat jemi në mospajtim.

6 Edhe çështjet për sa i përket alibisë apo njoftimit
7 dorëzimit të njoftimeve për alibi duhet të dimë çfarë janë
8 njëherë ato pretendimet të cilat janë në aktakuzë por janë të
9 redaktuara, përpara se të bëjmë një gjë të tillë.

10 Pra, pozicioni ynë është ky: Që ne do të përpiqemi dhe
11 jemi shumë të interesuar që t'i përmbahemi afatit për
12 dorëzimin e dosja paraprake dhe pastaj do të shqyrtojmë se
13 çfarë do të ngelet e patrajtuar dhe do të bëhen kërkesa
14 zyrtare për gjërat që duhen konsideruar në atë kohë. Por
15 sigurisht çdo informacion që kemi do ta japim menjëherë sapo
16 ta kemi.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emerson.
18 Z. Roberts.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] Shumë shkurtimisht. Kam shumë pak
20 për të shtuar nga ato që thanë kolegët, por ne i kemi trajtuar
21 të gjitha çështjet tona me shkrim, kështu që i përmbahemi
22 atyre.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Ellis.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Ne i përmbahemi parashtrimeve tona
25 me shkrim dhe miratojmë të gjitha çështjet që ngriti z.

1 Emmerson pak përpara.

2 Fokusi ynë që të përqipemi që t'i përmbahemi afatit të 21
3 tetorit për dosjen tonë dhe këto hapat e tjerë që kërkohen për
4 të kaluar ndërkohë do të na bëjnë që të vonohet procesi dhe
5 mund të kenë ndikim në dorëzimin e dosjes tonë paraprake.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit Z. Ellis.

7 Znj. Prokurore.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Në lidhje me alibinë, një numër
9 nga ekipet e Mbrojtjes thanë që nuk kanë mundësi që të bëjnë
10 mundësi për alibi për shkak të redaktimeve.

11 Por, në seksion -- në pjesën e aktakuzës që flet për
12 përgjegjësinë penale të të akuzuarve vetëm 4 nga 24 paragrafë
13 kanë redaktime. Njoftimi për alibinë sipas rregullës 95(5)
14 është një detyrim nga ana e Mbrojtjes. Pra, në qoftë se
15 Mbrojtja do të ngrejë një argument mbrojtës në bazë të alibisë
16 për ato pretendime apo akuza që janë të paredaktuara ata mund
17 ta bëjnë këtë në bazë të rregullës 95(5).

18 Nuk e di nëse dëshironi të them diçka për pikat e tjera.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

20 Në këtë fazë duhet të flasim vetëm për mundësitë hetimore
21 unike, por kemi kaluar tek pika tjetër tek alibia. Atëherë të
22 kalojmë tek njoftimi për alibinë apo bazat për përjashtimin e
23 përgjegjësisë penale.

24 Në parashtrimet e tyre Mbrojtja e ka rezervuar të drejtën
25 për të dhënë njoftimin për alibinë ose arsyet për përjashtimin

1 e përgjegjësisë penale.

2 Mbrojtja e Thaçit do të bëjë njoftim për alibi mbasi të
3 ketë më shumë qartësi në lidhje me datat dhe vendndodhjet e
4 incidenteve të pretenduara. Megjithatë, nuk mund të japë
5 informacion të mëtejshëm duke pasur parasysh redaktimet e
6 mëdha që kanë aktakuzat dhe në dosjen e Prokurorisë.

7 Mbrojtja e Veselit ka thënë që nuk mund të japë njoftim
8 për alibi apo arsye për përjashtimin e përgjegjësisë derisa të
9 marri versionin e paredaktuar të aktakuzës.

10 Dhe Mbrojtja e z. Selimi tha që tani potencialisht mendon
11 se mund të japi njoftim për alibi.

12 Mbrojtja e Krasniqit do të trajtojë çështjen e alibisë
13 apo të arsyeve për përjashtimin e përgjegjësisë penale në
14 dosjen e vet paraprake.

15 E ftoj Mbrojtjen të thotë se kur do të jenë në gjendje të
16 japim njoftimin për alibi apo për arsyet për përjashtimin e
17 përgjegjësinë penale, ndoshta në dosjen e tyre paraprake apo
18 edhe më herët.

19 Z. Kehoe.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju e përmbledhët shumë saktë
21 pozicionin tonë. Sigurisht jam -- dua të përsëri atë që tha z.
22 Roberts ku citoi ai paragrafët 41 dhe 42, unë do të citoja
23 paragrafin 141 ku janë hequr të gjitha datat, emrat, vendet,
24 etj. Është e pamundur që klienti im të thotë ndonjë gjë për
25 këto, pa e ditur, pa pasur informacion se për çfarë po flet

1 Prokuroria. Unë nuk e di se për çfarë e ka fjalën znj. Lawson
2 kur thotë që mund të bëhet njoftimi për alibinë. Alibia ka të
3 bëjë a ke qenë këtu në atë moment kur ka ndodhur kjo ngjarje?
4 Nuk është teori për përgjegjësinë penale.

5 Pra ne nuk mund të themi nëse kanë ndodhur këto ngjarje.
6 Dhe në shumë seanca të tjera klientët e mi, për shembull, ju e
7 keni dëgjuar që gjatë të gjithë kësaj kohe, klienti im dhe
8 klientët e tjerë kanë udhëtuar nëpër Belgjikë, për Shtetet e
9 Bashkuara, në Norvegji, në Francë, e Paris, ku kanë folur me
10 udhëheqës ndërkombëtarë dhe këto mund të kenë qenë gjatë kohës
11 së aktakuzës.

12 Si ka mund të japim ne njoftim për alibi kur nuk kemi
13 datat kur -- ose si ka mundësi të ketë dijeni klienti im për
14 çfarë po ndodh në terren kur ai mund të ketë qenë diku në një
15 shtet të huaj.

16 Pra, desha të theksoj që derisa të marrim materialet nuk
17 mund ta bëjmë dot këtë. Unë do të dëshiroja t'i fusja këto në
18 dosjen time paraprake, por pa këtë informacion nuk e bëjmë
19 dot.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emerson.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë mendoj që është e arsyeshme
22 që ne të bëjmë parashtrime sipas rregullës 95, për aq sa
23 mundemi të bëjmë në dosjen tonë paraprake, por me kush që, në
24 qoftë se nuk kemi materialet deri atëherë, sidomos për sa i
25 përket materialeve shfajësuese, atëherë ne mund të themi që në

1 dosjen paraprake çështja ose argumentet tona nuk janë dhënë të
2 plota.

3 Dhe me të gjithë këto kushte që përmenda, ne do të
4 përpiqemi që të dorëzojmë dosjen tonë paraprake deri në afatin
5 që keni dhënë ju dhe do të bëjmë ç'është mundur që të
6 përmbushim të gjitha kërkesat e tjera mbi bazën e
7 informacionit që kemi.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.

9 Z. Robert keni diçka?

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo, vetëm atë që e tha me shumë
11 elokuencë z. Emmerson. Ne paraqesim atë që kemi thënë në
12 paragrafin 32 të parashtrimit tonë me shkrim. Në mënyrë më
13 elokuate se aq nuk mund ta paraqesim.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Ellis.

15 Z. ELLIS: [Përkthim] Pajtohem me të gjithë parafolësit.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Të kalojmë tek pikat e
17 pajtimit për çështje ligjore dhe faktike.

18 Në parashtrimet me shkrim ZPS-ja ka thënë se ka pasur një
19 lloj progresi në lidhje me faktet e pajtuara. Sipas ZPS-së
20 është arritur marrëveshje me një ose më shumë ekipe të
21 Mbrojtjes për 22 fakte prej 300 propozimeve që bëri ZPS-ja në
22 mars 2021.

23 Sipas Mbrojtjes së Thaçit, Mbrojtja e Thaçit është
24 pajtuar me - më falni - me 9 fakte të tjera të cilat janë
25 riformuluar dhe megjithatë mbetet është e pamundur që të ketë

1 pajtim për fakte të tjera që ka propozuar ZPS-ja duke pasur
2 parasysh redaktimet e shumta.

3 Në parashtrimet e veta Mbrojtja e Veselit tha që ka
4 pranuar katër fakte të pajtuara dhe ka ofruar 6
5 kundërpropozime për të cilat ZPS-ja ka rënë dakord.

6 Mbrojtja e Veselit ka thënë se pajtohet me afatin e 1
7 shtatorit 2022 për trajtimin e këtyre dy kundërpropozimeve të
8 tjera.

9 Mbrojtja e Selimit po i rishikon faktet për të përcaktuar
10 nëse mund të pajtohet me to dhe vëren se shkëmbimi i
11 korrespondencave, i komunikimeve për disa fakte midis ekipeve
12 të tjera dhe Prokurorisë mund të ndikojë për ta përsheptuar
13 këtë proces.

14 Mbrojtja e Krasniqi ka rënë dakord për 8 propozime të
15 fakteve të pajtuara. Do të vazhdojë t'i shkojnë propozimet e
16 ZPS-së dhe këtë shqyrtim apo këtë rishikim do ta shikojë deri
17 me 1 shtator 2022.

18 Tani palët i ftoj që të japim një lloj kalendari afatesh
19 për diskutimet në këtë çështje.

20 Znj. Prokurore.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ju i
22 përmbloodhët me shumë saktësi këto statusin e deritanishëm të
23 çështjeve për sa i përket fakteve të pajtuara. Ka disa
24 propozime të tjera, shumë propozime të tjera për të cilat ende
25 nuk është arritur pajtim. Por, jemi në diskutim të vazhdueshëm

1 dhe jemi të gatshëm të vazhdojmë diskutimet me Mbrojtjen në
2 lidhje me propozimet e tjera që mund të paraqesë Mbrojtja. Dhe
3 duke pasur parasysh që nëse arrijmë marrëveshje për këtë,
4 atëherë kjo mund të bëhet deri me 1 shtator.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Siç e thatë ju, i nderuar Gjykatës,
6 ne kemi rënë dakord edhe për disa fakte të tjera dhe totali i
7 këtyre fakteve të pajtuara është 18. Nuk jemi në gjendje që të
8 biem dakord me fakte të tjera për shkak të arsyeve që i kam
9 përmendur më parë.

10 Por, kemi ndërmend që të dorëzojmë disa propozime ZPS-së
11 në lidhje me krimet që janë kryer nga serbët kundër popullatës
12 shqiptare të Kosovës të cilat janë të shumta në numër. Dhe
13 shpresojmë që mund t'i shikojmë këto krime të kryera dhe
14 kundër shqiptarëve të Kosovës dhe atyre që janë, domethënë,
15 vrasjeve të shqiptarëve të Kosovës nga serbët dhe kjo do të na
16 shkurtojë shumë kohë.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kam gjë për të shtuar.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Roberts.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Vetëm sa për të thënë që ne nuk e
21 dimë nëse do të jemi në gjendje që të biem dakord për faktet
22 deri me 1 shtator, por dëshirojmë që të propozojmë faktet
23 tona, por që të mos kufizohemi vetëm në ato fakte që propozoi
24 z. Kehoe. Do të ishte -- ka shumë gjasa që ne mund ta bëjmë
25 këtë kur të dorëzojmë dosjen paraprake.

1 Në lidhje me fakte të tjera besoj nga fundi i gushtit do
2 të jemi gati me to.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Ellis.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Ne nuk kemi ndonjë gjë për të shtuar
5 përveç atyre që kemi dorëzuar me shkrim por ne kemi ndërmend
6 ta plotësojmë, ta përfundojmë këtë proces deri me 1 shtator.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Ellis.

8 Prokurore keni diçka për të thënë?

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë për të shtuar.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë të kalojmë tek
11 kundërshtimet ndaj pranueshmërisë së materialit provues që
12 është nxjerrë.

13 Në parashtrimet me shkrim të vetat zoti -- Mbrojtja e
14 Thaçit indikoi se nuk është në gjendje të dorëzojë
15 kundërshtimet ndaj pranueshmërisë të provave deri me 8
16 shtator.

17 Mbrojtja e Veselit tha se do të jetë në gjendje të
18 dorëzojë kundërshtimet ndaj pranueshmërisë së provave për
19 materialin e rregullës 103 dhe në qoftë se materiali i kërkuar
20 do t'i jetë dhënë Mbrojtjes.

21 Mbrojtja e Selimit mendon se kundërshtimet ndaj
22 pranueshmërisë janë të parakohshme në këtë kohë. Megjithatë
23 ajo është e gatshme që të hyjë në diskutime paraprake me ZPS-
24 në se cilat dokumente mund të mos i kundërshtojë që të
25 pranohen si prova materiale, në qoftë se ZPS-ja i jep

1 informacionin relevant.

2 Mbrojtja e Krasniqit mendon se aftësia e vet për të
3 identifikuar kundërshtimet ndaj pranueshmërisë t; materialit
4 provues varet nga informatat që do t'i japi ZPS-ja Mbrojtjes
5 në lidhje me listën e provave materiale dhe modalitetet se si
6 do të bëhet dhënia e dëshmimeve.

7 I ftoj palët tani të bëjnë komentet e tyre.

8 Z. Kehoe.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Në lidhje me modalitetet e pranimit
10 të provave na duhet një lloj sqarimi nga ZPS-ja në lidhje me
11 këto dokumente. Kanë ndërmend t'i fusin jo nëpërmjet
12 dëshmitarëve apo nëpërmjet dëshmitarëve dhe apo -- kjo do të
13 edhe ketë ndikim edhe tek çështja e provueshmërisë së tyre.

14 Kemi shumë dokumente dhe nuk kemi asnjë ide se çfarë
15 lidhje kanë ato me dëshmitarë të caktuar për shkak të
16 redaktimeve. Dhe për këtë kemi folur edhe më përpara. Numri i
17 dokumenteve nga Zyra e Krimeve të Luftës e Serbisë edhe nga
18 Shërbimi i Zbulimit të Serbisë këto janë problematike. Çfarë
19 dokumentesh janë marrë nga autoritetet qeveritare, nga OJQ-të,
20 cilat dokumente keni ndërmjet që t'i përdorni. Këto janë një
21 nga tre çështjet që duhet t'i jepen përgjigje përpara se sa të
22 biem dakord në lidhje me çfarëdo çështje pranueshmërie të
23 këtyre provave.

24 Pra, edhe një herë, miratoj atë që tha z. Emmerson, për
25 sa i përket vendosjes së karrocës përpara kalit.

1 Nuk e di për sa i përket provave jashtë sallës së gjyqit.
2 Për shembull, në lidhje me dëshmitarët që kanë vdekur apo të
3 cilat janë marrë më vonë dhe ZPS-ja mund të përpiqet t'i fusi
4 ato si prova materiale pa pasur njohuri se cila -- në cilën
5 kategori bien këto dëshmi, nga këta dëshmitarë, atëherë, ne
6 nuk mund të biem dakord me pranimin e tyre si provë materiale.
7 Pra këto duhen diskutuar dhe debatuar. Ndofta kjo është një
8 çështje që duhet të vendoset nga Trupi Gjykses, por duhet një
9 herë të debatohet nga ana ligjore përpara se të vendoset për
10 pranueshmërinë e tyre.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Desha ta vazhdoj në këtë pikë.

12 Sigurisht në qoftë se ka dëshmitarë të cilët kanë vdekur
13 dhe nuk mund të vijnë këtu, të gjitha -- atëherë do të ketë
14 rregulla të caktuara të cilat do të zbatohen, të cilat
15 përfshijnë nxjerrjen e plotë të këtyre materialeve për
16 Mbrojtjen dhe për çdo -- dhe të përfshihet në to të gjitha
17 provat apo informacioni që ekziston për sa i përket
18 besueshmërisë së individëve dhe mbështetshmërisë dhe/apo të
19 dëshmisë së tyre.

20 Nuk ka pasur asnjë indikacion për sa i përket prejardhjes
21 së një numri të madh dokumentesh të cilat na janë dhënë. Nuk
22 ka asnjë indikacion se kush i ka shkruar dhe se si i ka marrë
23 Prokuroria ato në zotërim. Dhe ju e kuptoni i nderuar Gjykatës
24 që kjo lidhet edhe me mocionin sipas rregullës 103, që ju
25 është paraqitur për sa i përket dokumenteve që i ka dhënë

1 Prokurorisë, ZPS-së, Shërbimi i Zbulimit dhe Shërbimi i
2 Prokurorial i Serbisë. Të dy shërbime shumë fatkeqe. Këto janë
3 prova të cilat mund të jenë fabrikuara ose që janë marrë me
4 anë të torturës etj.

5 Pra dy kundërshtimet kryesore për sa i përket
6 pranueshmërinë së provave janë, e para, burimi, prejardhja. Në
7 poshtëshënimet e dosjes paraprake të Prokurorisë nuk jepet
8 asnjë indikacion se nga kanë ardhur këto dokumentet. Dhe ka --
9 jepen provat që ZPS-ja vetë i ka dhënë, të cilat ne e dimë
10 faktikisht që janë të falsifikuara mbasi kemi folur me
11 njerëzit të cilët i kanë dhënë ato dëshmi.

12 Pra, ndër këto materiale të Prokurorisë mund të ketë
13 materiale, shumë materiale të korruptuara. Pra, sigurisht
14 Trupi Gjykues do t'i dojë t'i shqyrtojë ato por ne nuk jemi në
15 gjendje të ecim përpara ndërkohë që Prokuroria nuk e ka
16 përfunduar nxjerrjen e këtyre materialeve dhe nuk e ka
17 përmbushur detyrimet e saj për nxjerrjen e materialeve edhe që
18 është shumë mbrapa në bërjen e kësaj. Dhe nuk po ndërmerr hapa
19 për të na dhënë neve prejardhjen e dokumentave që ka.

20 pra ne jemi në një pozitë kur ne të paktën më së paku
21 duhet të dimë, kë do të thërrasë Prokuroria që të dëshmojë
22 këtu në sallën e gjyqit, çfarë dokumentesh do të dorëzojnë si
23 prova materiale, se çfarë -- përmes dëshmitarëve dhe cilat
24 dokumente apo prova materiale do t'i dorëzojnë jo nëpërmjet
25 dëshmitarëve.

1 Pra, unë do të mendoja që ky ekzaminim i hollësishëm nuk
2 duhet të lejojë që të vonojë procedurën. Sepse duke parë
3 përparimin që ka bërë Prokuroria në përgjithësi, është e
4 pamendueshme që ata do të jenë në gjendje të na japim
5 përgjigje për këto çështje dokument pas dokumenti.

6 Por me këto çështje do të merremi gjatë gjykimit.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

8 Z. Roberts.

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Atëherë shumë shkurt, përsëri. Unë
10 miratoj pikëpamjet që u shprehën nga z. Kehoe dhe z. Emmerson.
11 Desha të korrigjoj një gabim që është bërë në dokumentin tonë
12 që thuhet 16,000 dokumenta, 16,218 dokumenta, por janë në fakt
13 janë 18,000 dokumenta.

14 Ne po përpiqmi dhe jemi të gatshëm që të angazhohemi në
15 mënyrë konstruktive dhe të identifikojmë se cilat dokumente
16 janë të rëndësishme për çështjen e Prokurorisë.

17 Mund të jenë -- nuk janë 18,000 mund të jenë 12,000
18 ndoshta s'janë as 5000, por në fakt rrezik mund të jenë 120-
19 130 materiale apo dokumente. Por duhet t'i dimë se cilat janë
20 dhe Prokuroria do të na ndihmojë që t'i identifikojmë ato duke
21 na treguar se cilët janë dëshmitarët që do të thërrasë,
22 dokumentet apo materialet që do të fusë si prova materiale
23 nëpërmjet tyre dhe cilat jo. Dhe sa më herët që të bëhet kjo,
24 aq më mirë.

25 Problemi me të cilin përballohem është që ne nuk e dimë

1 se çfarë rregullash procedurale dhe çfarë sistemi do të
2 miratojë Trupi Gjykses, si do të merren me dorëzimin e prova
3 materiale, etj. Nuk i kemi këto informacione. Për sa i përket
4 menaxhimit të gjykimit dhe kjo na çon në atë pikën tjetër që
5 ka të bëjë me racionalizimin e procesit gjyqësor dhe që e
6 përmendi edhe z. Young apo do ta përmendi më vonë, në qoftë se
7 i kemi të gjitha këto informacione, ne do të mund të ecim
8 përpara.

9 Ky është faktikisht ai elefanti në dhomë siç i thonë,
10 sepse sa kohë do të na duhet për të ndërmarrë këto hapa tani.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Këtë do ta diskutojmë në
12 lidhje me pikën e ardhme të rendit të ditës. Por, për momentin
13 fjalën e ka z. Ellis.

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Përsëri ne miratojmë parashtrimet e
15 ekipeve të tjera Mbrojtëse. Jmi në pozitën e njëjtë si edhe
16 ekipe të tjera.

17 Ju me siguri pyeteni i nderuar Gjykatës se çfarë mund të
18 përfshihet në dokumentet që duhen të dorëzohen. Për fat të keq
19 duke marrë parasysh pikën ku momentalisht mendojmë që këto
20 çështje do të debatohen hollësisht ashtu sikurse edhe na
21 paraqiten prej Prokurorisë dhe nga mënyra se si ajo ka
22 ndërmend të nxjerrë, të paraqesë provat e veta.

23 Në këtë fazë, nuk dua që t'i zgjeroj më shumë
24 parashtrimet tona rreth kësaj pike.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Ellis.

1 Znj. Prokurore, keni përgjigje?

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për sa i përket kundërshtimeve të
3 Mbrojtjes në lidhje me pranueshmërinë e dokumenteve sipas
4 rregullës 95 ftohet Mbrojtja që ta bëjë këtë. Parashtrime të
5 tilla duhet të bëhen në mënyrë të qartë duke përfshirë edhe
6 provat -- për provat që Mbrojtja - më falni - Prokuroria synon
7 t'i paraqesë. Ndryshe këto kritere duhet të përmbushen për aq
8 sa Mbrojtja të jetë në pozitë të jep një indikacion në lidhje
9 me çështjet për të cilat janë -- potencialisht mund të arrihet
10 pajtim.

11 Në fakt ne pajtohemi me Mbrojtjet se në të vërtetë shumë
12 nga çështjet në lidhje me pranueshmërinë duhet të trajtohen
13 ashtu siç paraqiten gjatë gjykimit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
15 Prokurore.

16 Tani do të shkoj tek pika e fundit e rendit të ditës, në
17 lidhje me racionalizimin apo kompaktësimin e procedurës apo
18 procesit.

19 Do t'ja jap fjalën secilës palë në lidhje me çdo propozim
20 që është bërë.

21 Një, numri i përditësuar i dëshmitarëve që do të thirren
22 dhe mënyra e dhënies së dëshmisë prej tyre. Dy, komunikimi i
23 listës së dëshmitarëve që ZPS-ja synon t'i thërrasë tre muajt
24 e parë të gjykimit. Tre, zvogëlimi i shtrirjes apo
25 fushëveprimit të çështjes. Katër, caktimi i datës, i kohës -

1 më falni - që do t'i jepet palëve për tu bërë pyetje
2 dëshmitarëve dhe a mund Mbrojtja të kompaktësojë pyetjet për
3 dëshmitarët e palës kundërshtarë. Pesë, sa orë në ditë dhe sa
4 javë në muaj do të jenë të disponueshme palët për të qenë në
5 seanca gjyqësore. Dhe gjashtë, mundësia për të përcaktuar afat
6 kohor të përgjithshëm për paraqitjen e provave prej palëve.

7 Së pari, në lidhje me listën e përditësuar të
8 dëshmitarëve.

9 Në parashtrimet e veta me shkrim ZPS-ja bën të ditur se
10 lista e dëshmitarëve mbetet e përditësuar për sa i përket
11 numrit të dëshmitarëve mbi të cilët do të mbështetet ZPS-ja.
12 Megjithatë ZPS-ja ka bërë të ditur që po vazhdon rishqyrtimin
13 e listës së provave materiale dhe të dëshmitarëve dhe si dhe
14 të propozimeve për paraqitjen e provave në mënyrë që të
15 racionalizohet numri i -- përllogaritja e përafërt që do t'i
16 duhet për marrjen në pyetje të dëshmitarëve. ZPS-ja thotë se
17 do të jetë në pozicion të jep një propozim të konsoliduar dhe
18 konkret paraprakisht, pra para transferimit të çështjes Trupit
19 Gjykues dhe se parashikon që do të jetë në pozitë të bëjë një
20 propozim të tillë deri nga mesi i tetorit 2022.

21 Ftoj ZPS-në që të paraqesë sa më shumë hollësi në lidhje
22 me këtë temë meqë kjo është thelbësore për sa i përket Trupit
23 Gjykues.

24 Gjithashtu, kërkoj nga ZPS-ja që të bëjë të ditur nëse do
25 të jetë në pozicion që të japë një përditësim më të fundit,

1 për shembull, përpara -- më herët, për shembull, përpara
2 konferencës për ecurinë e çështjes që do të mbahet në të
3 ardhmen.

4 Urdhërori, znj. Prokurore.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për sa i përket statusit të
6 listës së dëshmitarëve, sikurse e kemi thënë në parashtrimet
7 me shkrim për sa i përket numrit mbetet i njëjtë numri i
8 dëshmitarëve mbi të cilët mbështetemi. Në qoftë se do të ketë
9 ndryshime në këtë drejtim ne do ta njoftojmë paraprakisht
10 Mbrojtjen dhe do ta njoftojë gjithashtu edhe për propozime të
11 tjera në lidhje me racionalizimin e procesit.

12 Për sa i përket -- është pak e vështirë që t'i trajtosh
13 veç e veç çështjet që janë në fakt të ndërlidhura të rendit të
14 ditës. Do të ketë me siguri ndryshime në numrin e
15 përlllogaritur të orëve që do të duhet për marrjen në pyetje të
16 dëshmitarëve dhe kjo është rezultat i procesit të vazhdueshëm
17 apo në vijimësi të rishqyrtimit. Pra, si rezultat i këtij
18 procesi, i nderuar Gjykatës, ne presim që do të zvogëlohet
19 numri i orëve që do t'i duhet Prokurorit. Mirëpo, kjo varet
20 edhe nga rrethanat individuale të çdo dëshmitari si edhe nga
21 të drejtat dhe interesat e viktimave. Padyshim që varet edhe
22 nga elementët ligjorë si për shembull standardi relevant i
23 provës.

24 Në pyetjen në qoftë se mund t'i japim këto propozime më
25 përpara, pra para tetorit sikurse e kemi bërë të ditur në

1 parashtrimet tona duam të theksojmë se duhet që të marrim
2 parasysh gjithë punën që duhet të bëhet, të marrim parasysh të
3 gjitha propozimet. Ne nuk parashikojmë që të jemi në gjendje
4 të japim një propozim të tillë përpara mesit të tetorit, kur
5 edhe do të dorëzojmë listën e përditësuar të dëshmitarëve, ku
6 edhe do të paraqiten këto ndryshime.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Prokurore, a ju kam
8 kuptuar drejt se për momentin ju nuk planifikoni të zvogëloni,
9 ulni numrin e dëshmitarëve, por prisni që të ketë ndryshime në
10 mënyrën e dhënies së dëshmisë prej dëshmitarëve dhe në numrin
11 e orëve që do t'u duhet për të marrë në pyetje dëshmitarët? A
12 e kam kuptuar drejtë përgjigjen nga Prokurorja?

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, më keni kuptuar drejt, i
14 nderuar Gjykatës. Mbas propozimeve që i kemi brenda ZPS-së për
15 prezantimin e provave, parashikojmë që numri i orëve që do të
16 na duhet, do të jetë më i vogël. Nuk e përjashtoj mundësinë që
17 gjatë rishikimit ne edhe të vendosim të mos mbështetemi në
18 ndonjë dëshmitar pasi që të kemi bërë analizat e duhura.
19 Sidoqoftë nuk janë marrë vendime në këtë drejtim, në këtë fazë
20 dhe posa të merret një vendim i tillë do t'i njoftojmë palët.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
22 Prokurore.

23 Urdhëroni, z. Kehoe.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Në Konferencë për Ecurinë e Çështjes
25 të fundit, na u tha se Prokuroria ka ulur numrin e orëve prej

1 1856 në 1500. Kjo është një ulje e konsiderueshme prej 300 e
2 më shumë orëve. Por, sidoqoftë Prokuroria thotë se nuk ka
3 hequr asnjë dëshmitar nga lista.

4 Në këtë moment, sikurse duket se kur ka ulur këtë numër
5 orësh me 350 orë, Prokuroria ka bërë disa vendime, ka marrë
6 disa vendime lidhur me dëshmitarët dhe është detyrim i
7 Prokurorisë që të na tregojë pse tani nuk po humbasin shumë
8 kohë me ta.

9 Disa ndryshme janë bërë për shkak të moshës së
10 dëshmitarëve dhe Prokuroria ka përzgjedhur që t'i heqë ata
11 dëshmitarë nga lista. Dhe në qoftë se do ta bëjë këtë
12 Prokuroria atëherë mund të vazhdojmë nga ajo pikë dhe jo të
13 presim deri nga mesi i tetorit kur të marrim një vendim të
14 përgjithshëm apo kur të japë një propozim të përgjithshëm
15 Prokuroria.

16 Pra, në thelb, duhet të shikojmë se kush janë këta
17 dëshmitarë që janë më të rëndësishëm. Sikurse e dinë edhe vetë
18 avokatët e Prokurorisë ata nuk mund të paraqesin të gjitha
19 18,000 dokumente që i kanë si prova. Duhet të flasim për një
20 qasje të arsyeshme sesi do të vazhdohet me paraqitjen e
21 provave. Të zvogëlohet shtrirja e çështjes, numri i
22 dëshmitarëve, provat materiale, e të tjera dhe pastaj mund të
23 flasim se si ka ndërmend që të paraqesë provat e veta,
24 përfshirë edhe ato jo nëpërmjet dëshmitarëve. Ndryshe do të
25 humbin dy muaj deri nga mesi i tetorit duke u rrotulluar në

1 vend.

2 Në qoftë se për shembull gjithë ato orë ai numër i orëve
3 është zvogëluar atëherë me siguri është hequr edhe ndonjë
4 dëshmitar nga lista, mirëpo këtë informacion ne nuk e kemi. Në
5 qoftë se me të vërtetë ka ndodhur kështu ajo duhet të na
6 thuhet në mënyrë që të racionalizojmë procesin sa më mirë që
7 të jetë e mundur.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 Z. Emerson.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju doni të dëgjoni parashtrimet
11 në lidhje me të gjitha këto parashtrime menjëherë apo jo, i
12 nderuar Gjykatës?

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo, dua të dëgjoj
14 parashtrim tuaj në lidhje me përditësimin e listën e
15 dëshmitarëve të ZPS-së dhe pastaj do t'i kalojmë të gjitha
16 pikat një nga një.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Faleminderit për sqarimin.

18 Unë do të propozoj një gjë të dukshme për të gjithë ata
19 që i ndjekin këto proces -- këtë proces me një mendje të hapur
20 se ZPS-ja ka marrë përsipër më shumë se sa që mundet. Dhe nuk
21 po i plotëson detyrimet e nxjerrjes së materialeve që e kanë
22 ditur se i kanë si detyrim kur edhe kanë parashtruar aktakuzën
23 për konfirmimin dhe kur kanë kërkuar arrestime. Dhe në atë
24 kohë siç ju kujtohet i nderuar Gjykatës, përlllogaritja ishte
25 që çështja do të ishte e gatshme për gjykim në fillim të

1 marsit apo prillit të vitit të kaluar.

2 Pra, një gjë është absolutisht e sigurt se Prokuroria ka
3 marrë përsipër më shumë se sa që mund të bëjë.

4 Dhe këtë e dimë për arsye se kjo ka pasur për pasojë edhe
5 mungesën e fokusit apo përqendrimit. Nga parashtrimet e z.
6 Halling gjatë Konferencës së fundit e shohim se balanca nuk
7 është që të vendoset midis listës së dëshmitarëve si
8 dëshmitarë thelbësorë dhe atyre që konsiderohen të
9 rëndësishëm, por duhen të merren parasysh edhe interesat e
10 viktimave në përgjithësi.

11 Z. Halling konkretisht sugjeroi këtë që do të thotë se
12 çdo viktimë duhet të ketë të drejtën që të ketë përfaqësimin e
13 vet gjykim, çdo person që pretendon të jetë viktimë e krimeve
14 të pretenduara të kryera nga të akuzuarit.

15 Juve ju kujtohet Mbrojtësi i Viktimave z. Laws se çfarë
16 parashtrimesh bëri në atë Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes.
17 Në qoftë se Prokuroria nuk është e gatshme t'i plotësojë
18 afatet të cilat vazhdimisht janë zgjatur, është e qartë se ajo
19 që e thashë edhe më herët se Prokuroria ka marrë përsipër më
20 shumë sesa që mund të bëjë.

21 Me fjalë të tjera do ta kemi numrin e njëjtë të
22 dëshmitarëve por do t'i kalojmë me një shpejtësi më të madhe.

23 Me gjithë respektin që kam kjo nuk pajtohet me nocionin e
24 një mendje të përgjegjshme dhe të disiplinuar të Prokurorisë.
25 Nuk është konform me nocionin e një Prokurorie e cila edhe pas

1 dy vitesh nuk është në gjendje të paraqesë një listë reale të
2 dëshmitarëve që synon t'i thërrasë sepse nuk e di se cilët
3 dëshmitarë do t'i thërrasë. Dhe nuk mund të na e thonë këtë në
4 kohën e afërt sepse nuk e dinë as vetë.

5 Dhe tani, për sa i përket procesit të përgatitjes së
6 kësaj çështjes për transmetim Trupit Gjykues ajo që na thotë
7 Prokuroria është që "Nuk duam të disiplinohe mi do të
8 paraqitemi përpara Trupit Gjykues me numrin e dëshmitarëve që
9 i kemi", sepse askush nga ana e tjetër e sallës së gjyqit nuk
10 e ushtron një përqasje të disiplinuar të paraqitjes së
11 provave.

12 Edhe pas dy vitesh, me katër të akuzuar që mbahen në
13 paraburgim, një Prokurori që nuk ka një plan për gjykim është
14 një nocion shokues.

15 Pra, ne ju ftojmë që të mos i jepni më liri kësaj
16 Prokurorie, por ta detyroni që të arrijë një farë vendimi apo
17 të marrë vendime të rëndësishme gjatë kësaj vere. Në vend se
18 që të shkojnë në pushime verore, stafi i Prokurorisë duhet të
19 anulojë pushimet dhe të punojë, ta formulojë çështjen e vet,
20 të tregojë se cilët dëshmitarë do t'i thërrasë tre muajt e
21 parë të gjykimit, cilët janë 107 dëshmitarët e parë dhe atë
22 radhitjen e saktë. Pra, duhet të disiplinohen për nga ana
23 profesionale.

24 Sepse në qoftë se nuk e bëni këtë do të keni përpara një
25 Prokurori tejet joprofesionale, tejet ambicioze, absolutisht

1 dembele dhe e dimë të gjithë se me një Prokurori të tillë
2 gjykimi mund të zgjasë të paktën pesë deri në shtatë vjet.
3 Është vendim i juaj, i nderuar Gjykatës, se kur arrihet pika e
4 fundit, por ne sugjerojmë që mos ta lini këtë vendim për
5 shtator.

6 Nuk mundet Prokuroria që të vijë prej para jush dhe të
7 kërkojë një farë të mire. Nuk e kam për detyrë ta detyroj
8 Prokurorinë, të sillet ashtu siç duhet por e kam për detyrë ta
9 Mbroj klientin tim dhe të sigurohem se do të mund të fillojmë
10 me çështjen në kohën e duhur.

11 Ne duhet ta dimë çështjen me të cilën ballafaqohemi. Ju
12 me plot të drejtë na pyesni "kur do të jeni të gatshëm me
13 këtë", "kur do të përfundoni hetimet", e kështu me radhë. Por
14 ju duhet të keni parasysh atë pikëpamjen e përgjithshme. Dhe
15 është e dukshme se për sa i përket intervistave të
16 dëshmitarëve dhe protokollit në lidhje me dëshmitarët është e
17 dukshme dhe është e pashmangshme që Mbrojtja të dëmtohet.
18 Duhet të ndihmohet Mbrojtja. Këtë ndihmë mund t'ia japë
19 Prokuroria por Prokuroria nuk është e gatshme ta ndihmojë
20 Mbrojtjen.

21 Prandaj, ne duam ta dimë para konferencën e ardhme për
22 ecurinë e çështjes se cilët janë dëshmitarët e Mbrojtjes - më
23 falni - e Prokurorisë që vijjnë për të dëshmuar tre muajt e
24 parë të gjykimit dhe në çfarë renditjeje; së dyti, cilët janë
25 107 dëshmitarët e parë, domethënë një e treta apo 30% të

1 dëshmitarëve nga lista e dëshmitarëve që do të thirren, dhe
2 pastaj ne mund të përqendrojmë edhe hetimet tona, të bëjmë
3 kërkesat e nevojshme drejtuar Zyrës Administrative për
4 intervista me këta dëshmitarë e kështu me radhë.

5 Është një farë ekosistemi mjaft delikat. Njëri i
6 handikapon apo i dëmton nevojat e palës tjetër në vend se ta
7 ndihmojë atë. Ne nuk shohim një farë gatishmërie nga
8 Prokuroria për të bërë ndonjë gjë domethënëse që do t'i japë
9 formë gjykimit dhe ecuri këtij procesi. Mbrojtja nuk ka më se
10 ç'të bëjë nga ajo çfarë ka bërë deri tani. Është Prokuroria
11 ajo që po shkakton pengesa. Sepse nuk e dinë se cilët
12 dëshmitarë do të dëshmojnë kur, po janë të vendosur që t'i
13 vendosin në listë të gjithë këta njerëz për të dhënë dëshmi
14 përpara Trupit Gjykses dhe t'ju japin gjysmën e kohës për t'i
15 bërë rrëfimet e tyre.

16 Kjo nuk është një Prokuror profesionale. Unë ju ftoj që
17 të caktoni një afat të paktën shtatë ditë para Konferencës së
18 ardhshme mbi Ecurinë e Çështjes, për ato dy lista të
19 dëshmitarëve që i përmenda më parë me synimin për ta
20 kompaktësuar çështjen. Dhe të paktën edhe për 12 muajt e
21 ardhshëm në vartësi të numrit të ditëve që do të mbahet gjykim
22 apo javët që do të ketë gjykim e muaj e kështu me radhë. Në
23 këtë mënyrë ne do të jemi realisht në gjendje të paraqesim
24 edhe Mbrojtjen tonë.

25 Prokurori në qoftë se vazhdon ashtu siç po bën tani nuk

1 mund të paraqesë çështje në mënyrë kuptimplote dhe mund të
2 përfundojë sikur edhe Prokuroria e z. Millosheviq e cila
3 vazhdoi pa fund dhe në fund dështoi.

4 Na tha Kryeprokurori në fillim të kësaj çështje z. Smith
5 vetë se Prokuroria është e dizajnuar që të jetë më e shpejtë
6 se prokuroritë e tribunalëve të tjerë dhe na akuzoi ne, nëse
7 ju kujtohet, pra, Mbrojtjen se po e zmadhojmë çështjen e
8 kohëzgjatjes së gjykimeve të kësaj natyre. Tani jemi në një
9 situatë, në fakt, është dashtë të jemi në fazën përfundimtare
10 kur një çështje është e gatshme për gjykim. Por, ne nuk jemi
11 as afër një statusi të tillë. Pse? Sepse Prokuroria nuk di se
12 kush janë dëshmitarët, se cilët dëshmitarë do t'i thërrasë në
13 çfarë radhitje, çfarë dokumentesh do të paraqesin nëpërmjet
14 tyre, cila është prejardhja e atyre dokumenteve. Pra ata janë
15 tani në një gjendje në të cilën është dashtë të jenë para dy
16 vitesh.

17 Pra, me gjithë respektin ju ftoj edhe një herë që të
18 caktoni të paktën shtatë ditë përpara konferencës së ardhshme
19 që Prokuroria të na japë informacionin që e kemi kërkuar.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emerson.
21 Z. Young.

22 Z. YOUNG: [Përkthim] Miratojmë parashtrimet e Mbrojtjeve
23 të tjera dhe propozimin tuaj për përditësimin e listës së
24 dëshmitarëve të ZPS-së përpara mbajtjes së Konferencës së
25 ardhme për Ecurinë e Çështjes.

1 Duke mbajtur parasysh parashtrimet e ZPS-së dhe listën,
2 faktin që lista mbetet e njëjtë, ne supozojmë se Prokuroria
3 nuk e di për momentin se cilët dëshmitarë do t'i thërrasë. Në
4 fakt nuk duhet t'ju përkujtoj se në vitin 2020 Prokuroria
5 sugjeroi që ishin të gatshëm të fillonin gjykimin që në
6 pranverë të atij viti dhe këtë e përsëritën edhe në qershor
7 2021, para një viti.

8 Dhe tani ju ka mbetur dy muaj. Propozimi juaj, i nderuar
9 Gjykatës, për përditësimin e listës përpara shtatorit apo
10 Konferencës mbi Ecurinë të shtatorit është mjaft real. Ne
11 kërkojmë që Prokuroria të tregojë se cilët dëshmitarë do të
12 jenë në listë me çfarë radhitjeje. Kjo do të ndikojë në
13 procesin.

14 Dhe ne kërkojmë prej jush që ta përcaktoni këtë radhitje.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Ellis.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, klienti im ka
17 njëzet muaj që është në burg, ndërsa flasim. Kështu që në emër
18 të tij, nuk mund të fsheh irritimin e tij se pse është i
19 burgosur dhe nuk e kuptoj se pse Prokuroria nuk angazhohet për
20 një datë më të hershme për të përditësuar listën e
21 dëshmitarëve, sepse kjo ka të bëjë me çështje të tjera. Është
22 pyetje e vështirë. Pra pas njëzet muajsh ata nuk mund ta
23 përshpejtojnë dot këtë listë dëshmitarësh.

24 Por në sa konferencë për ecurinë e çështjes kemi
25 diskutuar për racionalizimin e çështjeve. Kjo nuk është

1 çështje e re kjo është temë që e kemi diskutuar shumë herë dhe
2 më përpara. Nuk mund të jemi në një pozitë të tillë që në mes
3 të tetorit, një javë përpara dorëzimit të dosja paraprake
4 Prokuroria të mund të prodhojë një listë dëshmitarësh që do të
5 ndryshojë tërësisht përmbajtjen e pyetjeve ose përmbajtjen e
6 trajtimit të Mbrojtjeve. Pra, sërish më lejoni të theksoj edhe
7 një herë që klientët tanë kanë shumë muaj që janë në burgim
8 dhe do ju bënim thirrje, i nderuar Gjykatës, t'i kërkon
9 Prokurorisë të përditësojnë afatin dhe të përgjigjen sa i
10 takon përditësimit të listave të dëshmitarëve.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Prokurore.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Sa i takon pyetjeve fillestare që
13 kanë të bëjnë me redaktimet ndaj dëshmitarëve pyetja ishte
14 shumë e qartë dhe përgjigja ime ishte po ashtu e qartë. Nuk ka
15 vendim sa i takon mbështetjes të dëshmitarët deri tani.
16 Mbështetur në uljen e orëve të gjykimit që janë 300 orë, jo
17 500 orë siç u tha nga z. Kehoe kjo është e vërtetë. Pra, kemi
18 ulje orëve të parashikuara deri tani.

19 Lista e dëshmitarëve është dhënë që gjashtë muaj më
20 përpara në dhjetor dhe siç e kam thënë dhe më përpara është
21 listë e sate sa i takon personave mbështetur të cilët ne do
22 të ndërtojmë çështjen tonë. Në qoftë se do të ketë ndryshime
23 sigurisht që do të njoftojmë Mbrojtjet përkatësisht.

24 Po ashtu, Mbrojtja ose sugjerimi që u përmend nga
25 Mbrojtja e z. Veseli që Prokuroria nuk e di çështjen e vet, ky

1 është një pretendim i përsëritur, por është çorientues si
2 parashtrimin. E vërteta është se ne kemi dhënë udhëzime lidhur
3 me çështjen e Prokurorisë që në fillim të procedurës.

4 Disa prej këtyre shifrave i kam përendur edhe më parë,
5 por në kuadrin e parashtrimeve që sapo u bënë ja vlen që t'i
6 përmend edhe një herë. Mbrojtja ka marrë mbi 1800 dokumente që
7 janë mbështetëse të aktakuzës në dhjetor 2020, në pajtim me
8 materialet që duhet nxjerrë me rregullën 86. Mbi 80-90 për
9 qind e dokumenteve tek të cilat ne do të mbështetemi si
10 Prokurori për çështjen janë dhënë që një vit më përpara, në
11 dhjetor 2021. Këto materiale janë nën-kategorizuar, nën-ndarë
12 në sistemin e Gjykatës që quhet *Legal Workflow*, ndërkohë një
13 listë paraprake e dëshmitarëve është dhënë në tetor 2021 dhe
14 është ndjekur nga lista e dëshmitarëve, lista materiale dhe
15 dosja paraprake me fund-shënimet në dhjetor.

16 Në janar është bërë një përshtkrim më i hollësishëm nga e
17 Prokurorisë në pajtim me tabelën e dokumenteve sipas rregullës
18 109 që u kërkua dhe që të parashtrihen në versionin e
19 përditësuar dhe në fillim të kësaj konference.

20 Ndërkohë sa i takon parashtrime të tjera që Prokuroria
21 është kaotike dhe nuk ka një drejtim, këto janë parashtrime të
22 cilat janë të pabazuar. Sa i takon listave të provave
23 materiale, statistikat dhe krahasimet që bëhen nga Mbrojtjet
24 janë çorientues. Mbështetur -- sa i takon mbështetshmërisë së
25 këtyre dokumenteve kjo është diçka që është përsëritur herë

1 pas here por është çuar një nivel më sipër dhe janë thjesht
2 parashtrime të pambështetura.

3 Sa i takon edhe afateve kohore edhe parashtrimet lidhur
4 me afatet janë të pabazuara. Afatet mund të jenë përshtatur
5 për arsyen bindëse gjë e cila është diskutuar në hollësi më
6 përpara dhe nuk do ta trajtoj këtu.

7 Megjithatë ne funksionojmë mbështetur mbi rregullore. Nga
8 njëra anë Mbrojtjet po refuzojnë që të respektojnë rregulltat
9 për sa i takon dosja paraprake dhe nga ana tjetër atakojnë
10 detyrimet të cilat rrjedhin për ZPS-në në një mënyrë që nuk
11 është parë nga institucione të tjera.

12 Ajo çfarë thashë më përpara është ende situata. Domethënë
13 çështja e Prokurorisë nuk do të ndryshojë, fushëveprimi i
14 çështjes nuk do të ndryshojë, natyra e çështjes nuk do të
15 ndryshojë nga propozimet për racionalizim apo nga listat e
16 përditësuarra të dëshmitarëve. Këto janë propozime që kanë të
17 bëjnë me paraqitjen e çështjes. Dhe kanë të bëjnë me redaktime
18 që janë të nevojshme. Në qoftë se do të ketë ndryshim të
19 dëshmitarëve do t'ju bëjmë njoftimet në kohën e duhur.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
21 Prokurore.

22 Shumë shkurtimisht z. Kehoe.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Shumë shkurt, Gjykatës. Pra, jam i
24 lumtur që Prokuroria tha që kjo është një Gjykatë rregullash.
25 Dua t'ju pyes, i nderuar Gjykatës, sa herë i keni dhënë afate

1 në pajtim me rregulloren ZPS-së, që ZPS-ja nuk i ka
2 respektuar. Të paktën 20. Sa herë i nderuar Gjykatës keni
3 kërkuar propozime për racionalizimin e kësaj çështjeje? Dhe
4 çfarë përgjigje ju ka dhënë ZPS-ja? Përgjigja që ju ka dhënë
5 ZPS-ja është që "Ne parashikojmë që të kemi mundësinë që t'ju
6 japim diçka diku nga tetori". Domethënë pas dy muajsh.

7 Unë besoj, i nderuar Gjykatës, dhe më korrigjoni në qoftë
8 se nuk e kam drejtë ju e keni ngritur këtë çështje të paktën
9 në dy konferenca të mëparshme për ecurinë e çështjes,
10 konferenca të ngjashme si kjo e sotmja. Pra, duke kërkuar
11 informacione të tjera. Dhe pas gjithë kësaj kohe, pas gjithë
12 këtyre muajve, përgjigja që ju jepet është që "Do t'ju japim
13 diçka nga tetori" dhe këtë përgjigje e japin në korrik. Dhe
14 këta njerëz mendojnë dhe thonë që respektojnë rregullat? Unë
15 thashë ashtu siç ishte që janë 300 orë më pak.

16 A jemi prapë realistë të themi që do të merren në pyetje
17 326 dëshmitarë ndërkohë që kanë zbritur ulej ose kanë ulur
18 orët e marrjes në pyetje të dëshmitarëve ndërsa flasim? Kjo
19 është kundër logjikës, kjo nuk ka kuptim. Nuk ka kuptim në
20 mënyrën se si procedojnë gjërat në një gjykatë normale.

21 Këto janë çështje që dua t'jua sjell në vëmendje, sepse
22 argumenti që sapo u paraqit është i pabazë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

24 Do të kalojmë shkurtimisht në zërat e tjera që kanë të
25 bëjnë me racionalizimin e çështjes.

1 Së pari, dua që t'ju kërkoj palëve që të jenë sa më të
2 shkurtë që të jetë e mundur sepse me sa kuptoj unë
3 parashtrimet që bëtë në pikat e para në axhendë zbatohen edhe
4 në pjesën e mbetur të rendit të ditës.

5 Do të kalojmë me komunikimin e listës së dëshmitarëve që
6 do të thërriten gjatë tri muajve të parë. Kjo është një
7 shqetësim i ngritur nga palët.

8 Në parashtrimet me shkrim ZPS-ja thotë që do të japë
9 listën dëshmitarë në kohën e duhur për Mbrojtjet dhe
10 mjaftueshmërisht përpara ditës së fillimit të gjykimit, por
11 nuk është në një pozitë për ta bërë një gjë të tillë tani.

12 Mbrojtja e Veselit i kërkon ZPS-së, së pari, të japë
13 listën e 32 dëshmitarëve që synon të thërrasë, në një mënyrë
14 që është e arsyeshme për ZPS-në për t'i thërritur këta
15 dëshmitarë dhe po ashtu 107 dëshmitarët e parë që synon që të
16 thërrasë.

17 Përpara se sa t'jua jap fjalën palëve, duke pasur
18 parasysh fushëveprimin e çështjes, është e domosdoshme për
19 menaxhimin e mirë të çështjes që të gjitha palët dhe
20 pjesëmarrësit të informohen mjaftueshëm paraprakisht sa i
21 takon rendit në të cilin do të thërriten dëshmitarët. Do të
22 jetë e dobishme për Trupin Gjykues dhe gjithashtu për palët
23 për të ditur paraprakisht në qoftë se ZPS-ja synon të paraqesë
24 intervista të dëshmitarëve në pajtim me rregullën 153 dhe 154,
25 në qoftë se ZPS-ja synon të parashtrojë një kërkesë për fakte

1 të gjykuara në fillim të gjykimit edhe sesi ZPS-ja do të
2 strukturojë paraqitjen e çështjes së saj. Për shembull, në
3 qoftë se do të fillojë me vendet konkrete të krimit apo në
4 qoftë se synon që të paraqesë së pari prova që kanë të bëjnë
5 me konfliktin e armatosur dhe organizimin e UÇK-së.

6 Ftoj ZPS-në të na japë parashtrimet e saj lidhur me këtë
7 temë. Dhe në qoftë se nuk mund të japë parashtrime sot lidhur
8 me këtë temë të na thotë se kur mund të na japë një shpjegim.

9 Znj. Prokurore, fjala për ju.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Sa i takon rendit të dëshmitarëve
11 që ZPS-ja synon që të thërrasë në procesin gjyqësor, kjo siç e
12 kemi thënë në parashtrimet me shkrim, kjo varet shumë në datën
13 e fillimit të gjykimit, kalendarin e Trupit Gjyqësor,
14 gjithashtu disponueshmërinë e dëshmitarëve që do të thërriten
15 për të dhënë dëshminë e tyre. Kjo varet gjithashtu edhe me
16 kohën kur do të dorëzohen dosja paraprake nga Mbrojtjet. Varet
17 gjithashtu edhe nga puna e institucionit, sepse do të duhet që
18 të dërgohet çështja përpara Trupit Gjyqësor përpara se sa të
19 kemi mundësi të japim përgjigje për këtë çështje.

20 Sigurisht, që ne do të bëjmë përpjekjet e duhura që këto
21 çështje të mund të njoftohen paraprakisht për palët, por për
22 momentin ne nuk mund t'ju japim informacion që na kërkuat.

23 Po ashtu, mbajta shënim komentet tuaja, i nderuar
24 Gjykatës, lidhur me mënyrën e dhënies së dëshmisë që do të
25 reflektohet në listën e përditësuar të dëshmitarëve që do të

1 dorëzojmë përpara transferimit të çështjes, dërgimit të
2 çështjes përpara Trupit Gjykses. Për sa i takon fakteve të
3 gjykuara edhe këtë element e mbajtëm shënim dhe do të bëjmë
4 reflektimet e nevojshëm në udhëzimet që do të japim.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
6 Prokurore.

7 Z. Kehoe.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Jam dakord me dorëzimin e listave të
9 dëshmitarëve për tre muajt e parë të gjykimit. Kjo është
10 procedurë normale. Mund të ndodhë që një dëshmitar këtu apo
11 një dëshmitar aty, do të duhet që të dorëzojë për shkak të
12 kalendarit. Por, është jashtë logjike që një çështje e
13 përmasave të tilla që të jetë planifikuar në mënyrë të tillë,
14 që të na jepet lista e dëshmitarëve që synohet që të pyeten
15 nga Prokuroria. Jam i sigurt që Prokuroria i ka këto lista. Në
16 qoftë se ata nuk duan të na i japin është punë për ta.

17 Por, nuk mund të kesh një çështje të një dimensionit të
18 tillë pa e pasur idenë se si do ta fillosh çështjen, se kë do
19 të thërrasësh të parin. Kështu që i kërkoj Gjykatësit që të na
20 urdhërojë, të urdhërojë ZPS-në që të na japë listën e
21 dëshmitarëve që do të thërrasin gjatë tre muajve të parë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson, besoj që e
23 cekët këtë temë përpara.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, e ceka.

25 Prokuroria ofroi, në qoftë se mund të shprehem kështu, se

1 duket sikur është një proces ujdie, pra Prokuroria tha që do
2 të japi informacion në kohën e duhur që nuk do të thotë asgjë
3 dhe përpara gjykimit të procesit gjyqësor që është e dukshme
4 që është e kuptueshme. Përveç kësaj ne nuk bëjmë asgjë tjetër
5 kjo është një çështje për dhomën gjyqësore.

6 Megjithatë, për çështje që u shpjeguan më sipër për
7 protokollin e dëshmitarëve ne duhet të jemi shumë ekonomikë
8 për sa i takon përgatitjes së Mbrojtjes dhe për sa i takon
9 edhe hetimeve, që hetimi sigurisht që besojmë që do të jetë në
10 vijimësi edhe gjatë procesit gjyqësor.

11 Në qoftë se Prokuroria ka një vizion se si synon t'i
12 paraqesë provat e veta dëshmitarët e vet dhe duhet ta dimë
13 këtë gjë sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë të tillë
14 që ne ta strukturojmë ose ta formojmë planifikojmë mbrojtjen
15 tonë sipas as logjike. Në qoftë se nuk na jepet ky informacion
16 ky është pengim i drejtësisë.

17 Nuk po sugjeroj që ata nuk mund ta ndryshojnë këtë
18 pozicion mund të ndodhë për shembull që 10 për qind e
19 dëshmitarëve ose 30 për qind e dëshmitarëve që synojnë të
20 thërrasin në muajin e parë ndofta nuk janë të disponueshëm,
21 por për arsye koherence, siç e dini edhe ju i nderuar
22 Gjykatës, ata nuk mund të jenë kaotikë. Pra, është absolutisht
23 është shumë e rëndësishme ata të kenë listën e dëshmitarëve.
24 Në qoftë se nuk e kanë kjo do të ishte shumë problematike. Jam
25 i sigurt që ata duhet të kenë një plan pra, duhet që të dinë

1 se me çfarë do të fillohet. Do të fillohet me skenën ne krimin
2 me çfarë.

3 Dhe në qoftë se ata e kanë një racionalizim të tillë, në
4 qoftë se e kanë një plan të tillë, atëherë këtë informacion
5 duhet të na e japin në mënyrë të tillë që ne mbrojtjen të mund
6 ta strukturojmë në mënyrë sa më konstruktive që të jetë e
7 mundur. Nëse e kanë këtë qasje, ata duhet të urdhërohen që ta
8 formulojnë pozicionin e tyre gjatë pushimit të verës. Kjo nuk
9 diçka që i duhet lënë në dorë menaxhimit të Trupit Gjykses,
10 sepse në atë fazë ata do të jenë në një pozicion që të na
11 çojnë prapë në humbje kohe.

12 Përndryshe në qoftë se nuk na jepet informacion ne do të
13 humbin gjithë informacionin dhe gjithë kohën për përgatitjen
14 dhe kjo do të na bëjë ne të vonohemi.

15 Sigurisht që ata nuk duan që të na e kalojnë topin ata
16 nuk duan që të na ndihmojnë në mënyrë të kuptimtë dhe
17 përnjëmend është e paqartë që ata po na pengojnë, për sa i
18 takon bërjes së drejtësisë për qëllimet e tyre. Kështu që në
19 këto rrethana siç e thashë edhe më përpara do ju ftonim që të
20 urdhëronit ZPS-së që 7 ditë përpara konferencës së ardhshme
21 për ecurinë e çështjes të mund të japin listën e 32
22 dëshmitarëve të parë që 10 për qind e dëshmitarëve të
23 përgjithshëm që planifikohet nga ZPS-ja që ZPS-ja synon të
24 thërrasë në procesin gjyqësor. Dhe pastaj të na japin edhe 10
25 për qind të dëshmitarëve të tjerë që planifikojnë që të

1 përdorin më pas.

2 Në qoftë se kanë një arsye të mirë që të ndryshojnë
3 planin askush nuk do t'ju thonë pse po e bëni këtë gjë. Por
4 është detyra jonë që të sigurohemi që të dimë se cila është
5 lista e dëshmitarëve në mënyrë të tillë që të bëjmë
6 planifikimet përkatëse të Mbrojtjes.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young.

8 Z. YOUNG: [Përkthim] Mbështesim atë çfarë tha, çfarë u
9 tha më përpara. Kjo është një çështje e rëndësishme që ka të
10 bëjë me menaxhimin e lëndës gjyqësore. Prokuroria duhet të
11 ketë një plan në mendje dhe duhet të këtë një ide të qartë se
12 kë synon të thërrasin gjatë tre muajve të parë.

13 Dhe në qoftë se ka ndryshime ose në të ardhmen në qoftë
14 se do të bëjnë ndryshime, për shembull, gjatë tre muajve të
15 parë, është e rëndësishme për ju i nderuar Gjykatës që të
16 nxirrni një vendim në mënyrë të tillë që ne të planifikojmë
17 dhe të përqendrohemi te përgatitja e tre muajve të parë të
18 procesit gjyqësor. Dhe një herë ju kërkoj fuqimisht që të
19 nxirrni një urdhër për këtë çështje.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. Ellis, fjala për ju. Jo, më falni, z. Baiesu.

22 Z. BAIESU: [Përkthim] Jemi plotësisht dakord me atë çfarë
23 u tha nga ekipet e tjera të Mbrojtjes, në veçanti me
24 propozimin e z. Emmerson, që kjo listë duhet që të dorëzohet
25 sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo kur t'i vijë koha në

1 momentin e përshtatshëm siç u formuluar nga ZPS-ja.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Baiesu.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të paktën njëri prej ekipeve të
4 Mbrojtjes ka thënë në parashtrimet me shkrim që për një sërë
5 faktesh që e kufizojnë procesin gjyqësor, ka gjëra të cilat
6 nuk mund të jenë të vendosura në këtë fazë.

7 Siç e kam thënë në parashtrimet e mëparshme por
8 gjithashtu edhe në parashtrimet me shkrim së pari duhet të
9 merren parasysh ndryshimet për kohën dhe kalendarin. Domethënë
10 elementi praktik është diçka që nuk mund të jepet në këtë
11 pikë. Së dyti, ka një numër të konsiderueshëm faktorësh që
12 mund të kenë ndikim mbi vendimmarrjen, për shembull, dosjet
13 paraprake njoftimet për alibi dhe çështje të tjera.

14 Sërisht, dëshirojmë që të theksojmë masën e njoftimeve që
15 ka Mbrojtja sa i takon dëshmitarëve që do të thirren. Sa i
16 takon listave të dëshmitarëve paraprakë, ne i kemi dhënë
17 listat që në tetor të vitit që shkoi dhe kemi dhënë edhe
18 dokumente të tjera disa muaj më përpara. Pothuajse janë vit më
19 përpara.

20 Së fundi, parashtrimet nga Mbrojtja e Veselit që
21 përshkruan çështje të zhvillimit të procedurave, që dua ta
22 theksoj edhe një herë, që janë në përputhje të plotë me
23 praktikën përkatëse. Ndërkohë që cilësimi që u bë nga Mbrojtja
24 e z. Veseli që ky është pengimi i drejtësisë është absolutisht
25 i pabazuar dhe është një parashtrim joprofesional dhe jo i

1 përgjegjshëm.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

3 Prokurore.

4 Z. Kehoe, dëshironi të përgjigjeni?

5 Ju lutem mos përsërisni gjërat që u thanë se u bë sa kohë
6 që po diskutojmë për këtë element.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk do të përsëris, por ka, duket
8 sikur ka një element që nuk e ka fare parasysh Prokurori. Koha
9 është elementi. 326 dëshmitarë kë do të thërrasin ata? Në
10 qoftë se çështja duhet të ecë përpara me shpejtësi duhet të
11 kemi një afat kohor parasysh.

12 Sigurisht që ata e dinë se çfarë drejtimi do të marrë
13 çështja e tyre. Kështu që në mënyrë të tillë që çështja të ecë
14 me shpejtësi, duhet që të jepet informacion i duhur dhe në
15 mënyrë që të shkurtohet apo kufizohet koha në të cilën këta
16 zotërinj vazhdojnë të jenë në burg, është detyrë e Prokurorisë
17 që të japë këto informacione. Dhe elementi i kohës nuk merret
18 fare parasysh në asnjë prej parashtrimeve të bëra nga
19 Prokuroria.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E shoh që ka ardhur koha
21 për një pushim se përkthyesit kanë një orë e 45 minuta që
22 punojnë. Kështu që do të bëjmë një pushim 25 minuta dhe do të
23 mblidhemi këtu në orën 17.30 për pjesën e mbetur të zërave në
24 rendin e ditës.

25 Do t'ju kërkoj gjithashtu që të jeni të shkurtër në

1 pjesën e fundit të konferencë për ecurinë e çështjes në mënyrë
2 që të përfundojnë ndofta nga ora gjashtë.

3 Seanca ndërpritet këtu.

4 --- Pauza fillon në orën 17.07

5 --- Seanca rifillon në orën 17.30

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani të kalojmë tek pika e
7 tretë, në pjesën e tretë të Konferencës për Ecurinë e Çështjes
8 që janë masat për racionalizimin e çështjes.

9 Dhe do të diskutojmë reduktimin ose zvogëlimin e
10 çështjes.

11 Në parashtrimet e veta ZPS-ja ka thënë se në këtë fazë
12 nuk do të heqë asnjë dëshmitar apo vendndodhje krimi.

13 Mbrojtja e Selimit mendon se sa më vonë që të merret një
14 vendim në lidhje me këto reduktime apo zvogëlime të çështjes
15 aq më shumë kohë do të harxhohet nga Mbrojtja duke parë
16 materialet.

17 Unë e ftoj ZPS-në që të thonë nëse ka ndërmend të
18 reduktojë çështjen dhe kur do të jetë në gjendje ta bëjë këtë.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ne nuk po shikojmë a të
20 zvogëlojmë çështjen në vetvete, por mënyrën e paraqitjes të
21 dëshmive.

22 Për sa i përket zvogëlimit të numrit të dëshmitarëve ne
23 nuk e përjashtojmë këtë, por atë që po bëjmë deri tani ne nuk
24 e kemi parashikuar një gjë të tillë. Mund të bëhet -- ne e
25 dimë që kjo do të ndikojë tek përgatitja e Mbrojtjes dhe do ta

1 njoftojmë Mbrojtjen sa më shpejt që të jetë e mundur.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Atëherë, kjo do të thotë që
3 përgjigja është që ata nuk do ta zvogëlojnë çështjen, nuk do
4 të ulin numrin e dëshmitarëve dhe të vendndodhjeve të
5 incidenteve.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Vetëm një parashtrim në lidhje me
8 këto. Përveç parashtrimeve që bëra më përpara në lidhje me
9 këtë çështje.

10 Në shumë raste në përgjigje të një parashtrimi me gojë
11 apo me shkrim kjo është një përpjekje, faktikisht, që të vihet
12 UÇK-ja në gjykim. Të sillet para gjyqit. Dhe Prokuroria thotë
13 që nuk është ky gjykim ky kundër UÇK-së, por disa anëtarëve të
14 saj. Në qoftë se kjo është e vërtetë, atëherë s'duhet të kenë
15 asnjë kundërshtim që të hiqen vendndodhje të krimeve ku e
16 vetmja lidhje që është vendosur është një lidhje nëpërmjet
17 dikujt që identifikohet si anëtar i UÇK-së dhe nuk ka asnjë
18 lidhje me ndonjë prej këtyre dëshmitarë - më falni - këta të
19 akuzuar dhe me vendndodhjet e krimeve. Kjo -- në qoftë se
20 hiqen këto raste, atëherë kjo do ta reduktonte shumë çështjen
21 dhe mund të kursejë muaj e muaj dëshmish të cilat nuk do të
22 kishin lidhje me çështjen e Prokurorisë. Në qoftë se
23 Prokuroria i përmbahet pretendimit të saj se ky nuk është sulm
24 ndaj UÇK-së.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young.

1 Z. YOUNG: [Përkthim] Nuk kam asnjë përgjigje.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Aidan Ellis.

3 Z. Baiesu.

4 Z. BAIESU: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mbrojtja ka bërë këto parashtime
6 edhe më parë dhe këto janë çorientuese, sepse ne nuk kemi
7 ndonjë përpjekje për të paraqitur në gjyq UÇK-në.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Ky parashtim që bëri Prokurorja nuk
10 është i drejtë. Faktikisht paragrafët e aktakuzës përfshijnë
11 të gjithë anëtarët e UÇK-së, praktikisht. Rishikoni, i ftoj të
12 gjithë që të shikojnë paragrafët 35 të aktakuzës dhe kush nga
13 UÇK-ja është lënë jashtë këtij përshkimit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

15 Tani të kalojmë në pikën tjetër.

16 Znj. Prokurore, shumë, shumë shkurt.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po vërtetë shumë shkurt. Ne i
18 ftojmë njerëzit të lexojnë paragrafin 35 të Aktakuzës në
19 kontekstin e jurisprudencës së DHSK-së. Dhe përsëri ky avokat
20 Mbrojtës po bën përfaqësime të gabuara të fakteve.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani të kalojmë në afatet
22 kohore për marrjen në pyetje të dëshmitarëve.

23 Në parashtimet e veta Mbrojtja e Thaçit ka thënë se
24 është kundër vendosjes së afateve kohore dhe mendon se do të
25 ishte në shkelje të të drejtave të të akuzuarve sidomos të

1 drejtës për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme. Mbrojtja e
2 Thaçit po kështu është kundër caktimit të një përfaqësuesi për
3 të bërë pyetje në emër të të gjithë ekipeve Mbrojtëse.

4 Mbrojtja e Veselit tha që nuk është në gjendje të japë
5 afate kohore për marrjen në pyetje të dëshmitarëve. Ajo
6 gjithashtu mendon se caktimi i një avokati i një përfaqësuesi
7 që të bëjë pyetje në emër të të gjithë ekipeve Mbrojtëse nuk
8 mund të merret në këtë moment.

9 Mbrojtja e Selimit nuk është kundër afateve kohore për
10 marrjen në pyetje të secilit dëshmitar, në vartësi të katër
11 fakteve, të faktorëve dhe Mbrojtja e Selimit mendon që caktimi
12 i një përfaqësuesi për të bërë pyetje në emër të gjithë
13 Mbrojtjes është në kundërshtim dhe me të drejtat dhe është
14 problematik.

15 Mbrojtja e Krasniqit gjithashtu është kundër këtij
16 sugjerimi.

17 Tani i kërkoj Mbrojtjes të thonë mendimet e tyre.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, do të flas shumë shkurt për
19 këtë. Në këtë moment në kohë është shumë herët që të themi se
20 duhet të kufizohet koha në të cilën do të merren në pyetje
21 dëshmitarët dhe për temën e caktimit të një përfaqësuesi, unë
22 e kuptoj se çfarë doni të arrini ju, i nderuar Gjykatës, por
23 ajo që ndodh në këto çështje gjyqësore me avokatët mbrojtës që
24 janë me përvojë, zakonisht njëri nga avokatët njëri nga
25 mbrojtësit bën pyetjet kryesore dhe pastaj të tjerët bëjnë

1 pyetje plotësuese.

2 Pra në rendin normal të gjërave unë mund t'ju them se kam
3 shumë përvojë në këtë punë, kështu do të veprojmë edhe ne si
4 avokatë mbrojtës. Dhe nuk është momenti tani për tu marrë me
5 këtë çështje.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Kehoe.
7 Atëherë nga sugjerimi juaj është që, ju nuk doni që të
8 angazhoheni, të thoni që pajtoheni me caktimin e një përfaqësi
9 të vetëm për të bërë pyetje në emër të Mbrojtjes, por në
10 praktikë ju do të bëni diskutime *inter partes*, me njëri-
11 tjetrin në mënyrë që të mos ketë përsëritje në bërjen e
12 pyetjeve nga Mbrojtja.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Po. Ashtu është e saktë.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në qoftë se nuk e fikni
16 mikrofonin askush nuk më dëgjoi. Thjesht desha të them që jam
17 dakord me këtë propozim. Dhe në realitet përsëritja e pyetjeve
18 humb kohën jo vetëm të të gjithëve, por edhe nuk është në
19 mënyrën e të bërit të gjërave nga Mbrojtja. Pra, kjo është në
20 interes të të gjithëve.

21 Për sa i përket çështjes së parë, dua të siguroj që
22 pozicioni jonë është i qartë. Ne kemi punuar në të kaluarën
23 brenda afateve kohore për marrjen në pyetje të dëshmitarëve
24 dhe është -- edhe përcaktohet edhe koha, për shembull, se
25 marrja në pyetje nga pala kundërshtarë mund të bëhet për një

1 minutazh të caktuar. Ndoshta mund të kërkohet më shumë kohë,
2 por këto janë çështje që kanë bëjnë me menaxhimin e çështjes
3 gjyqësore nga Trupi Gjykses.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young.

5 Z. YOUNG: [Përkthim] Për sa i përket afateve kohore ne
6 themi që kjo çështje duhet të diskutohet dëshmitar pas
7 dëshmitari me të Trupin Gjykses kur të vijë koha.

8 Për sa i përket pikës së dytë që një përfaqësues të bëjë
9 pyetje në emër të të gjithë ekipeve të mbrojtjes, ne jemi
10 krejtësisht kundër kësaj. Ne jemi të gjithë avokatë me përvojë
11 dhe jemi marrë me këto lloj çështjesh edhe më përpara. Kjo
12 është diçka që bëhet në mënyrë organike dhe do të zgjidhet
13 vetë gjatë gjykimit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Baiesu.

15 Z. BAIESU: [Përkthim] Ne i përmbahemi parashtrimeve tona
16 me shkrim dhe ne nuk pajtohemi me propozimin që Mbrojtja duhet
17 të caktojë një përfaqësues.

18 Por, ne jemi në dijeni të nevojës për të mos bërë
19 përsëritje në bërjen e pyetjeve dhe për të mos vonuar
20 procedurat. Por caktimi i një përfaqësuesi është i panevojshme
21 dhe ndërhyr në të drejtat për gjykim të drejtë të të
22 akuzuarve. Kaq janë parashtrimet e mia.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Baiesu.

24 Znj. Prokurore dëshironi të thoni diçka lidhur me këtë?

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ne mendojmë që caktimi i afateve

1 kohore është një mënyrë e arsyeshme për vazhdimin e çështjes,
2 e zhvillimit të çështjes, por kjo është një çështje për të
3 cilën do të merremi vesh me Mbrojtjen dhe është çështje e
4 menaxhimit të gjykimit.

5 Për sa i përket propozimit të Mbrojtjes për koordinimin e
6 kundërpyetjeve -- e pyetjeve që do të bëjnë ata ne mendojmë që
7 kjo është mënyrë e arsyeshme për të vepruar. Siç e thanë dhe
8 vetë avokat mbrojtës nuk përfiton askush nga pyetjet e gjata
9 dhe zgjatja e afateve.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Unë do ta përmend në
11 dokumentin tim për dorëzimin e çështjes Trupit Gjykues që
12 palët bien dakord për një organizim organik, zgjidhje organike
13 të propozuara nga Mbrojtja.

14 Tani do të kalojmë në pikën tjetër në pjesën e
15 parafundit.

16 Në parashtrimet me shkrim. Mbrojtja ka parashtruar që të
17 sipas kalendarit të mbahen seanca katër herë në javë.

18 Mbrojtja e Veselit ka thënë që të bëhen katër ditë të
19 plota me seanca me një ditë pushim dhe me një javë pushim mbas
20 katër javësh.

21 Mbrojtja e Selimit ka thënë që çdo kalendar duhet të
22 respektojë të drejtat e të akuzuarve dhe duhet fleksibilitet
23 për të çuar procedurat përpara dhe të gjitha aktivitetet që do
24 të bëhen në Gjykatë duhet të jenë efektive dhe të mos lexohen,
25 për shembull, përmbledhjet e deklaratave të dëshmitarëve të

1 cilat do të vonojnë proceduat.

2 Dhe së fundi Mbrojtja e Krasniqit nuk beson që është
3 realiste që të bëhen pesë ditë në javë seanca dhe ata
4 propozojnë që të ketë katër ditë në javë seanca dhe një ditë
5 jashtë ku do të punohet jashtë seancave, plus disa ditë të
6 përcaktuara në muaj për të bërë punë të tjera.

7 Znj. Prokurore.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
9 Siç e kemi thënë në parashtrimin tonë ne jemi të gatshëm të
10 vijmë këtu çdo ditë kur të fillojë gjykimi, megjithatë, mund
11 të ketë përshtatje të orareve sipas nevojave.

12 Çdo kalendar i tillë nuk duhet të pengojë apo të zgjasë
13 ardhjen e një dëshmitari apo qëndrimin më gjatë të një
14 dëshmitari këtu. Këto janë çështje -- që të gjitha këto
15 kufizimet në ditët e javës në të cilat mbahet seanca duhet të
16 kenë një lloj fleksibilitet.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Keni diçka nga Mbrojtja?

18 Z. Kehoe.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Asgjë.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Desha që ju, i nderuar Gjykatës,
22 të fusni në dokumentin e dorëzimit të çështjes arsyet pse ka
23 konsensus nga ana e Mbrojtjes që duhet të bëhen blloqe -- në
24 mbajtjen e seancave duhet të bëhet në blloqe të caktuara dhe
25 asnjëherë të mos ndërpritet desh mia e një dëshmitari në mes.

1 Ne -- nuk është e çudi që Prokuroria me burimet që ka në
2 dispozicion dhe gjendjen ku është pret që do të -- kur do ta
3 fillojë gjykimin, këtë sigurisht Prokuroria mund të thotë që
4 mund të bëjnë seanca çdo ditë, por më e rëndësishme se kjo
5 është se ne duhet të vazhdojmë dhe do të vazhdojmë hetimet
6 tona dhe strategjitë tona hetimore.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ka dikush tjetër për të
8 thënë?

9 Z. YOUNG: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Baiesu.

11 Z. BAIESU: [Përkthim] Ne pajtohemi me z. Emmerson që koha
12 që nevojitet për përgatitjen gjatë procesit të gjyimit është
13 e rëndësishëm, sidomos sepse duhet të bëjmë hetime dhe të
14 përgatitemi për një numër dokumentesh të cilat ende nuk janë
15 dorëzuar apo do të dorëzohen me vonesë ose të cilat do të
16 dorëzohen 30 ditë para dhënies së dëshmisë. Po kështu
17 identiteti i dëshmitarëve për shumë dëshmitarë do të na jepet
18 30 ditë përpara dhënies së dëshmisë dhe përgjigje këto duhet
19 të përgatitemi.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Radziejowska, a keni
21 diçka për të thënë në lidhje me këto çështje që u ngritën
22 këtu?

23 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
24 Gjykatës. Nuk kemi ndonjë parashtrim në lidhje me këto, por
25 thjesht t'i përgjigjem sugjerimit të z. Emmerson se çfarë tha

1 z. Laws gjatë Konferencës së fundit për Ecurinë e Çështjes.
2 Transkripti i asaj seance në faqen 89, rreshti 4, deri në
3 faqen 91 rreshti 25 dhe pastaj faqet 100, rreshti 1-14, aty
4 thuhet se çfarë saktësisht tha z. Laws dhe sugjerimi që bëri
5 z. Emmerson sot, është thjesht i gabuar.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
7 Radiejowska.

8 Nuk e di a ka parashtime të tjera. Do të kalojmë te pika
9 tjetër që është afatet kohore tërësore për gjithë palët.

10 ZPS-ja pajtohet që të caktohet një numër total i orëve që
11 do të marri secila palë. Ajo mendon se kjo mund të shprehet më
12 mirë si një numër orësh se sa si një periudhë kalendarike.

13 Mbrojtja e Thaçit mbështet përcaktimin e afateve kohore
14 të përgjithshme për secilën nga palët Mbrojtëse, por është
15 kundër vendosjes së afateve kohore tremujore për parashtrimin
16 e çështjeve të Mbrojtësve.

17 Mbrojtja e Veselit është e gatshme t'i pranojë afatet
18 kohore për parashtrimin e provave siç është paraqitur në
19 propozim.

20 Dhe Mbrojtja e Krasniqit mendon që kjo është e
21 parakohshme të vendoset tani.

22 Znj. Prokurore keni diçka për të shtuar?

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju e parashtruat shumë mirë
24 pozicionin tonë.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Kehoe.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Ne në përgjithësi jemi në favor të
2 afateve kohore të përgjithshme që të përcaktohen. Unë për
3 shembull kam pasur një çështje në Tribunalin e Hagës ku kishim
4 shumë të pandehur por 75 për qind e kohës i kushtohet
5 klientit. Pra, është pak e vështirë që të përcaktohet se çfarë
6 afatesh kohore do të vendosim.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë a ju kam kuptuar
8 drejt se nuk e kundërshtoni caktimin e një afati të
9 përgjithshëm, por se kjo mund të vendoset pasi të paraqiten
10 provat prej Prokurorisë. A është kështu?

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Po e thatë më mirë se unë, i nderuar
12 Gjykatës.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë kjo mund të
14 përfshihet në dokument dorëzimi.

15 Faleminderit z. Kehoe.

16 Z. Emmerson.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar ndaj
18 parashtrimeve me shkrim përveçse t'ju përkujtoj se pozicionin
19 tonë në lidhje me një synim prej një viti kalendarik.

20 Në qoftë se do të ndahet blloqe prej tre muajsh, tre
21 muaj, tre muaj, tre muaj, është diçka do të ishte për t'u
22 vendosur midis Mbrojtjeve, ekipeve të ndryshme të Mbrojtjes.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po, për këtë arsye edhe
24 propozova nga tre muaj për çdo ekip të Mbrojtjes.

25 Z. Young, ju a keni diçka për të shtuar?

1 Z. YOUNG: [Përkthim] Asgjë për të shtuar, vetëm se ju
2 bashkohem parashtrimeve të z. Kehoe.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. Baiesu.

5 Z. BAIESU: [Përkthim] Vetëm të shtoj se në propozimin
6 tonë për racionalizimin e çështjes, Dosja 810 ne kemi
7 parashtruar se një vit kalendarik duhet të jetë kohë e
8 përgjithshme për paraqitjen e provave të Prokurorisë dhe ne i
9 qëndrojmë këtij propozimi.

10 Ne pranojmë parimin e barazisë midis palëve dhe nevojën e
11 një proporcionaliteti midis kohëzgjatjes së çështjes së
12 Prokurorisë dhe asaj të Mbrojtjes.

13 Faleminderit z. Baiesu.

14 Znj. Radziejowska, a keni ndonjë gjë për të shtuar në
15 lidhje me këtë pikë?

16 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë në këtë
17 moment.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

19 Atëherë të kalojmë tek data e Konferencës së ardhme për
20 Ecurinë e Çështjes. E kam ndërmend që ta caktoj mbajtjen e
21 konferencës së ardhme me 8 shtator 2022, e enjte në orën
22 13.30. kërkoj nga palët nëse do të jenë të disponueshme për
23 atë takim.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, jemi të disponueshëm.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Edhe ne.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po.

2 Z. YOUNG: [Përkthim] Po.

3 Z. BAIESU: [Përkthim] Po.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Radziejowska.

5 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Po, edhe ne do të jemi të
6 disponueshëm.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

8 Atëherë, tani do ta diskutojmë çdo pikë tjetër që nuk
9 është përfshirë në rendin e ditës dhe për këtë do të kalojmë
10 në seancë private.

11 [Seancë private]

12 [Seancë private teksti i fshirë]

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16 [Seancë e hapur]

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës,
18 jemi në seancë publike.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit Sekretare.

20 Përpara se sa të përfundojmë me seancën e ditës së sotme,
21 do të nxjerr dy urdhra gojorë.

22 Tani do të lëshoj urdhrin e dytë gojor që ka të bëjë me
23 përditësimin e listave të dëshmitarëve.

24 Duke marrë parasysh parashtrimet e palëve, urdhëroj ZPS-
25 në që të dorëzojë një listë dëshmitarësh që përditëson mënyrën

1 e marrjes në pyetje dhe paraqitjen e kohës për secilin prej
2 dëshmitarëve deri më 2 shtator 2022.

3 Kjo përmbyll urdhrin e dytë gojarisht të lëshuar prej
4 meje.

5 Tani do të lëshoj urdhrin e tretë gojarisht.

6 Duke marrë parasysh parashtrimet e palëve, urdhëroj ZPS-
7 në që të plotësojë njoftimin sipas rregullës 102(3) deri me 7
8 tetot 2022.

9 Kjo përfundon urdhrin e tretë gojarisht.

10 Ky është fundi i seancës së ditës së sotme. Falënderoj
11 palët dhe pjesëmarrësit për pjesëmarrjen e tyre. Si gjithmonë,
12 falënderoj përkthyesit, stenografët, teknikët audiovizivë dhe
13 stafin e sigurisë për ndihmën e tyre.

14 Seanca përfundon këtu.

15 --- Konferenca për Ecurinë e Gjendjes mbyllet
16 në orën 18.20

17

18

19

20

21

22

23

24

25